

الله
رسول
محمد

HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)

FRIKA ND AJ ALLAHUT

O ju që besuat, keni frikën ndaj All-llahut dhe
le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër,
dhe keni frikë All-llahun, e s'ka dyshim se
All-llahu është që e di në detaje atë që punoni.

(Sure Hashr: 18)

Cfarë ndryshimi do të kishte në jetën e dikujt nëse do të kishte mundësi që të shikonte me sytë e vet demonët e Xhehenemit duke ndëshkuar banorët e tyre, ulërimat e flakëve, britmat e çmendura të të dënuarve, rënkimet e padurueshme dhe psherëtimat e tyre, përpëlitjet për frymëmarrje dhe kërkesën e tyre të furishme që të lejohen të kthehen në Tokë.

Pa dyshim, dikush mund të bëhet një person i ri, e ka mundësi që të riorganizohet e të korrigjojë një jetë të tërë.

Në se fakti që ne nuk e kemi parë Xhehenemin, po pengon disa njerëz që ti mos i frikësohen Allahut ashtu siç duhet dhe që të mos jenë të kujdesshëm në jetën e tyre të përditshme, duhet të jetë më se e mjaftueshme që Ai e ka treguar ekzistencën e Xhehenemit në mënyrë të përsëritur në Kuran, duke e përshkruar atë në mënyrë të detajuar dhe duke paralajmëruar njerëzit kundër tij.

Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t'i afrohet atij. Ky (kontaktimi i xhehenemit) është vendim i kryer i Zotit tënd.

Pastaj, (pas kalimit pranë tij) do t'i shpëtojmë ata që ishin ruajtur (mëkat-eve), e zullumqarët do t'i lëmë aty të gjunjësuar. (Sure Merjem: 71-72)

Mirëpo, nuk do të ketë dobi ose përparësi nëse do ta kishim parë Xhehenemin në këtë pikë, sepse pikërisht atëherë, njeriu është tashmë përtej pikës pa kthim.



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën. Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



FRIKA NDAJ ALLAHUT

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)



PËR AUTORIN

Injohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në

Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.



Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preçiz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

PËR LEXUESIN

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin në dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjeluar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

FRIKA NDAJ ALLAHUT

© Ju që besuat, keni frikën ndaj All-llahut dhe
le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër,
dhe keni frikë All-llahun, e s'ka dyshim se
All-llahu është që e di në detaje atë që punoni.
(Sure Hashr: 18)

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)

GLOBAL PUBLISHING

Kayisdagi Mah. Degirmen Sok. No: 3
Ataşehir-Istanbul / TURKEY Phone: (+90 216)
660 00 59

Printed by: Secil Ofset
100. Yil Mahallesi MAS-SIT Matbaacilar Sitesi
4. Cadde No: 77 Bagcilar -Istanbul / Turkey
Phone: (+90 212) 629 06 15

E-Mail: info@globalkitap.com
<http://globalkitap.com>

www.harunyahya.com/albanian
www.harunyahya.com
www.en.harunyahya.TV

P Ë R M B A J T J A

Parathënie	10
Allahu urdhëron në Kuran që t'ia kemi frikën Atij	13
Frika ndaj Allahut siç përshkruhet në Kuran	16
Pse besimtarët i frikësohen Allahut?	20
Çfarë vlera morale posedon personi që i frikësohet Allahut?	36
Cilësitë që fiton një besimtar për arsye se i frikësohet Allahut	42
Shpërblimet për ata të cilët i frikësohen Allahut.....	47
Arsyet e dështimit për t'iu frikësuar Allahut	54
Çfarë vlera morale posedon një person i cili nuk i frikësohet Allahut.....	69
Pasojat që vuajnë ata të cilët nuk i frikësohen Allahut	81
Përfundim	88
Mashtrimi i evolucionit	90

PARATHËNIE

Në këtë çast, ju nuk jeni vetëm në dhomën ku po lexoni këtë libër. Edhe atëherë kur keni menduar se jeni vetëm, ju në të vërtetë nuk keni qenë kurrë vetëm. Engjëjt e caktuar nga Allahu pandërprerë mbikëqyrin dhe shkruajnë gjithçka që ju bëni. Në atë moment që ju thoni një fjalë ata e shkruajnë atë. Çdo hap i juaji, çdo mendim, çdo gjë që ju bëni, duke përfshirë edhe obligimet që keni shtyrë për më vonë, të gjitha regjistrohen pa përjashtim.

Këta engjëj nuk bëjnë dallim në mes të veprave të vogla apo të mëdha. Edhe kur jeni në gjumë ata janë vazhdimisht me ju. Ata i përmbushin detyrat e tyre në mënyrën më të përpiktë. Ata nuk harrojnë dhe as nuk gabojnë kurrë, ata i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të përkryer. Në mënyrë të njëjtë, engjëjt e vdekjes të caktuar për ju janë po ashtu duke pritur. Për çka presin ata? Presin që koha e përcaktuar për ju të përmbushet. Kur t’ju arrin koha e vdekjes e përcaktuar për ju, ata janë ata që do ta marrin shpirtin tuaj.

Përveç tyre, ekzistojnë edhe dëshmitarë tjerë të cilët ende nuk i kemi përmendur, ata për të cilët ju nuk mendoni, këta janë dëshmitarët tuaj të fshehtë: duart tuaja dhe lëkura juaj. Në Ditën e Gjykimit, të gjithë këta dëshmitarë do të mblidhen, dhe me lejen e Allahut do të flasin dhe do të dëshmojnë për ju. Nëse ndodhë që të jeni prej atyre që nuk e kanë pasur frikën e Allahut, apo nëse nuk keni qenë një person i vëmendshëm, ata do të dëshmojnë kundër juve.

Njerëzimi është krijuar për të adhuruar Allahun dhe pandërprerë vihet në

sprovë. Ekzistenca e përkohshme e njeriut është mesatarisht rreth gjashtëdhjetë vjet, që nuk është kohë aq e gjatë para se njeriu të sillet në fund para Allahut për të dhënë llogari për çdo sekond të jetës së tij. Allahu pastaj do të vendos për formën e jetës së amshueshme të përshtatshme për ta. Nëse një person posedon vepra të mira atij do t'i jepet Libri nga ana e tij e djathtë dhe ai person do të jetë i shpëtuar përjetësisht. Mirëpo, nëse është prej atyre të cilëve Librat u jepen nga ana e tyre e majtë, ai pastaj do të thotë:

“... Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time!

Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!” (Sure Hakka: 25-29)

Prej këtij momenti ai do të kapet, do të tërhiqet me fytyrë zvarrë për tokë dhe do të dërgohet në Xhehenem (Ferr), për t' mos u nxjerr më kurrë prej aty.

Arsyeja që qëndron pas këtij fundi të tmerrshëm, është se njerëzit kurrë nuk kishin imagjinuar se çdo veprim i tyre do të regjistrohet dhe një ditë do të zbulohet dhe do të jepet llogari për të, dhe kështu kanë kaluar jetët e tyre në mënyrë të shkujdesur pa pasur frikën e Allahut dhe pa u vënë veshin paralajmërimeve të Tij. Një person si ky i cili nuk posedon një formë të qartë të besimit për Ahiretin (Jetën e përjetshme), për Ditën e Gjykimit apo për një vend të tmerrshëm të ndëshkimit për veprat e këqija dhe sjelljen e shkujdesur, si Xhehenemi, nuk do të ngurrojë të shpërfill kufijtë e Allahut.

Për këtë arsye frika ndaj Allahut është një tregues i fuqishëm i besimit në Allahun dhe një tregues i rëndësishëm për atë që mund të pres njeriu në Jetën e amshueshme. E vetmja rrugë drejt sigurisë mbështetet mbi vetëdijen që frymëzon frikë-respekt ndaj Allahut dhe mbi maturinë e ndërgjegjshme.

Dita e Gjykimit është një realitet i frikshëm për të cilin duhet menduar me frikë-respekt në mënyrë që të bëhet e pamundshme që të mos ndikohesh prej saj. Mirëpo, kjo frikë vlen vetëm për njerëzit besimtar dhe është një lloj i veçantë i frikës sepse Allahu ka përshkruar atë që do të ndodhë në Ditën e Gjykimit në shumë vargje të Kuranit; shkruesit, dëshmitarët dhe grumbullimin

e një mase të pafund të njerëzve. Kjo është një e vërtetë absolute, e cila pranohet në mënyrë të pakushtëzuar nga besimtarët e vërtetë të cilët i frikësohen ballafaqimit me një përvojë të tillë të tmerrshme dhe të hidhur.

Gjithçka që ju bëni regjistrohet menjëherë, madje edhe kur jeni duke e lexuar këtë libër. Shpejt po i afroheni ditës kur do të thirreni nga Allahu për të dhënë llogari për veprimet tuaja. Prandaj ne shpresojmë që të jemi prej atyre të cilët kanë fituar kënaqësinë e Allahut përmes vetëdijes që frymëzon frikë-respekt ndaj Tij:

... Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur! (Sure Bekare: 197)

(Takva nënkupton ndërgjegje, frikë-respekt ndaj Allahut, që frymëzon një person të jetë vigjilent ndaj veprave të këqija dhe të jetë i paduruar për të bërë vepra të cilat kënaqin Atë. Në këtë libër, do të përkthehet si “frika ndaj Allahut” apo “ruajtja nga e keqja” apo “ndershmëria” në pajtim me kontekstin.)

ALLAHU URDHËRON NË KURAN QË T'IA KEMI FRIKËN ATIJ

Frika ndaj Allahut nuk është, siç supozohet nga disa njerëz, një cilësi e veçantë vetëm për profetët dhe ata të cilët janë veçanërisht të afërt me Të por më tepër është një ndjenjë që bartet në zemrat e të gjithë besimtarëve dhe një ndjenjë që duhet ta ketë tërë njerëzimi. Urdhri i Allahut në Kuran është i qartë:

O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kini frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! (Sure Hashr: 18)

Profeti ynë (savs) gjithashtu tërhoqi vëmendjen ndaj kësaj çështjeje në shumë thënie të tij, duke i përkujtuar besimtarët që gjithmonë ta kenë frikën e Allahut:

“Kini frikën e Allahut kudo që jeni; nëse pasoni një vepër të keqe me një të mirë do ta fshini atë; dhe me njerëz silluni në mënyrë të njerëzishme.”
(Tirmidhiu)

Allahu ka krijuar tërë njerëzimin dhe është jashtëzakonisht mirë i njohur me ta dhe i njeh ata më mirë se që e njohin ata veten e tyre. Ai e din atë që çdo njeri mban të fshehur madje edhe në skutat më të fshehta të qenieve të tyre. Ai është plotësisht i vetëdijshëm për format e mosbesimit që përjeton shpirti dhe lojërat që do të luhen nga uni sepse Ai është krijuesi i çdo shpirti i ka dhënë atij aftësi të pafund të bëj ligësi dhe frymëzim për t'iu shmangur të keqes në mënyrë që të mund të gjykohet me drejtësi. Allahu ka krijuar po ashtu Shejtanin si pjesë e

kësaj sprove dhe i ka dhuruar atij disa cilësi të veçanta për t'i përdorur në ndjekje të këtij qëllimi.

Për këtë arsye përkrahja më e madhe për sprovën jetësore të një besimtari është frika ndaj Allahut sepse kjo do t'i mundësojë një personi të sillet ashtu si kërkon Allahu, të punoj për të fituar kënaqësinë e Allahut, të mbroj vetveten prej joshjeve të Shejtanit dhe ephshit duke qenë i vetëdijshëm për to dhe duke iu bërë ballë dredhivë dhe lojërave të tyre. Një dispozitë e tillë nuk i shkon për shtati përpjekjeve të Shejtanit për të manipuluar dëshirat e pafund të ephshit të një personi.

Për këtë arsye, epshi i njeriut, me nxitjen e Shejtanit, do të bëjë përpjekje para së gjithash që ta largojë vëmendjen e tij nga frika ndaj Allahut. Ata do të përpiqen të largojnë vëmendjen e tyre nga frika ndaj Allahut dhe të mos jenë të vëmendshëm ndaj Tij duke sugjeruar se kjo nuk është e domosdoshme apo madje e gabuar dhe se dashuria ndaj Allahut dhe posedimi i një zemre të pastër është ajo që ka rëndësi. Mirëpo, një lexues i ndërgjegjshëm i Kuranit do të kuptojë me lehtësi se sugjerimet si këto nuk kanë bazë reale dhe se ato përmbajnë një qëllim plotësisht të devijuar dhe mashtrues, ngase Allahu u ka urdhëruar besimtarëve që ta kenë frikë Atë në Kuran në mënyrën më të qartë të mundshme. Ky urdhër gjendet në shumë ajete të Kuranit:

... Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Ai dënon ashpër. (Sure Bekare: 196)

... Ta keni frikë Allahun e ta dini mirë se vetëm tek Ai do të tuboheni! (Sure Bekare: 203)

... Kini frikë Allahun dhe ta dini se Allahu është i Dijshëm për çdo gjë! (Sure Bekare: 231)

... Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Allahu i sheh mirë të gjitha punët që bëni ju. (Sure Bekare: 233)

O besimtarë! Kini frikë Allahun, përpiquni që t'i afroheni Atij me vepra të mira dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar! (Sure Majde: 35)

Sikurse për çdo çështje tjetër, një besimtar do të përpiqet që në mënyrë të pa rezervë dhe të pakushtëzuar ta përmbush këtë urdhër të Allahut. Për dallim prej atyre që nuk janë të vetëdijshëm për Kuranin dhe të cilët e vënë në dyshim domosdoshmërinë apo rëndësinë e frikës ndaj Allahut, ata nuk janë të çorientuar nga sugjerimet dhe nxitjet e Shejtanit të cilat do të shkaktojnë shqetësime hutuese lidhur me atë se pse një person që e do Allahun duhet t'ia ketë frikën Atij. Ndërsa falja e përditshme e namazit dhe agjërimi janë praktika të obligueshme që duhet të përmbushen në mënyrën më të mirë të mundshme, frika ndaj Allahut është një gjendje thelbësore shpirtërore e domosdoshme të cilën një besimtar duhet të përpiqet me sinqeritet ta ngjallë brenda vetes së tij. Bashkë me këtë, Allahu ka zbuluar në hollësi në Kuran urtësinë hyjnore se pse njeriu duhet të ketë frikë ndaj Tij. Këtë çështje do ta shtjellojmë në hollësi në kapitujt në vazhdim.

FRIKA NDAJ ALLAHUT SIÇ PËRSHKRUEHET NË KURAN

O besimtarë!

*Kini frikë Allahun ashtu si i takon
Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!*

(Sure Ali Imran: 102)

Ajeti “**kini frikën e Allahut ashtu si i takon Atij**” zbulon një çështje e cila është trajtuar në Kuran në mënyrën më të hapur dhe më të hollësishme. Çfarë lloji i frikës, çfarë niveli i gjendjes shpirtërore dhe ashpërsia e ndalimit të gjitha janë shpjeguar individualisht në ajetet e Allahut. Pa dyshim se ky është njëri prej synimeve më të rëndësishme të shpalljes së Kuranit:

Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i Vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur! (Sure Ibrahim: 52)

Tani do të shohim se si duhet t’i frikësohemi Allahut përmes ajeteve të Kuranit.

**Të kemi frikën e Allahut ashtu siç dimë më së miri
Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni, dëgjoni e binduni... (Sure Tegabun: 16)**

Në Kuran, Allahu i ka shpjeguar në hollësi njerëzimit fuqinë e tij të amshueshme, pozitën dhe superioritetin madhështor të Tij, si edhe ndëshkimin

e ashpër që Ai ka përgatitur për ata të cilët kanë ngritur krye kundër Tij. Duke e pasur këtë parasysh pritet që njeriu të reflektoj thellë mbi këto realitete me sinqeritet dhe si qëllimet e njeriut ashtu edhe veprimet e tij duhet të pasqyrojnë një qëndrim të informuar ndaj tyre. Njeriu duhet t'i qaset kësaj çështjeje në mënyrë aktive, siç tregohet në ajetin Kuranor, sa më mirë që mundet. Domethënë, njeriu duhet të çmojë fuqinë e Allahut sa më mirë që din dhe të jetë i kujdesshëm ndaj paralajmërimeve të Tij për ndëshkimin e përjetshëm në Xhehenem. Në këtë mënyrë, frika ndaj Allahut do të bëhet një e vërtetë e natyrshme në zemrën e një njeriu. Gjithashtu, një besimtar duhet, aq sa ka mundësi, të ketë frikë dhe të jetë i kujdesshëm për moskryerjen e adhurimit të obliguar siç përshkruhet në Kuran, si edhe për kryerjen e veprave të ndaluara, sepse gjërat për të cilat duhet të frikësohemi dhe të jemi të kujdesshëm janë shpjeguar po ashtu në hollësi në Kuran:

Dhe kështu, Ne e kemi zbritur Kuranin në gjuhën arabe dhe i kemi shpjeguar paralajmërimet, që ata t'ua vënë veshin. (Sure Ta Ha: 113)

Këtu duhet të sqarojmë një çështje shumë të rëndësishme: frika ndaj Allahut nuk është një ndjenjë e cila mund të arrihet duke kaluar nëpër stacione të shumta dhe të vështira shpirtërore. Përkundrazi, është një ndjenjë e fuqishme që e ndien në mënyrë të pashmangshme çdo njeri që mendon pa paragjykim. Personi që dëshiron të posedoj një frikë të vërtetë ndaj Allahut do të mund ta arrinte këtë përmes një akti të sinqertë të të menduarit. Domethënë, personi që mendon madje edhe një sekond për vdekjen dhe pasojat me të cilat ndeshemi pas vdekjes mund të zhvillojë këtë ndjenjë të ndërthurur të frikës, frikë-respektit dhe nderimit. Kjo varet plotësisht nga mendjemprehtësia e personit dhe nga aftësia e tyre për të qenë të sinqertë.

Ta kesh frikën e Allahut edhe pse nuk e sheh Atë

Për të shmangur hutinë me frika tjera të dynjasë, Allahu ka përshkruar po ashtu në Kuran ndjenjat edhe gjendjen shpirtërore të një besimtari i cili i frikësohet Allahut. Frika e besimtarit ndaj Allahut është një frikë që nuk

ngjason me asnjë lloj tjetër të frikës; kjo frikë është jashtëzakonisht e thellë dhe përplot respekt. Ky lloj i frikës dallon prej çfarëdo frike tjetër dhe nuk ka për qëllim të ngjallë dhimbje dhe siklet. Është krejtësisht e kundërta, ajo i përkujton njerëzit për përuiljen e tyre dhe të qenit rob i Allahut dhe hapë dhe zgjeron vetëdijen dhe intelektin. Kjo frikë i mundëson një personi të arrij një nivel shumë të lartë të sjelljes së drejtë.

Kjo frikë do të ngrit dëshirën e zjarrtë të një besimtarit për Ahiretin dhe do të nxis shpresën dhe lakminë për Ahiret. Frika ndaj Allahut e ngrit po ashtu për shumë herë afërsinë dhe dashurinë e besimtarit ndaj Allahut; është një ndjenje thelbësore e cila lejon përjetimin e kënaqësive të mëdha shpirtërore. Kurani përmend në shumë ajete frikë-respektin e thellë që posedojnë besimtarët:

Vërtet, për ata që i frikësohen Zotit të tyre pa e parë Atë, do të ketë falje dhe shpërblim të madh! (Sure Mulk: 12)

Dhe ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të mbahen, që kanë frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarisë së rëndë; (Sure Rra'd: 21)

(Xheneti është) për secilin që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga Allahu). (Sure Kaf: 33)

Ata, të cilët kumtuan shpalljet e Allahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij. Allahu mjafton si llogaritës. (Sure Ahzab: 39)

Ndjenja e shpresës e përzier me frikë

Edhe pse një besimtar i frikësohet Allahut, ai nuk duhet të harroj kurrë dhembshurinë, mëshirën dhe faljen e Allahut, apo se Ai është Ai i Cili për shkak të bujarisë së Tij pranon pendimin. Kjo si pasojë do të jetë arsyeja e posedimit të një ndjenje të sinqertë të shpresës, ndërsa përjeton frikë të vërtetë. Një frikë e fuqishme ndaj Allahut do të frymëzojë një nivel të thellë të të

menduarit për këto veti të Allahut, duke mundësuar që madhështia dhe superioriteti i Allahut të çmohet shumë më tepër, duke rezultuar me një afërsi më të madhe ndaj Allahut. Njeriu do të zhvillojë një perceptim më të qartë të mëshirës së Allahut, bujarisë së Tij dhe faljes së Tij të pafund.

Prandaj, një besimtar i vërtetë do t'i drejtohet dhe do t'i lutet Allahut në një gjendje shpirtërore plot frikë dhe shpresë:

Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. (Sure Sexhde: 16)

Ky është një tregues se frika ndaj Allahut nuk ka qenë kurrë një ndjenjë që shkakton dëshpërim dhe pesimizëm. Në shumë ajete të Kuranit deklarohet se një Musliman duhet të ketë një gjendje të vazhdueshme të shpresës:

Dhe mos bëni çrregullime në Tokë, pasi është vënë rregulli, ndërsa Atij lutjuni me frikë dhe shpresë. Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve. (Sure Araf: 56)

Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti. (Sure Zumer: 53)

Në anën tjetër, dëshpërimi është karakteristikë e jobesimtarëve, gjë e cila tregohet gjithashtu në ajete të ndryshme Kuranore:

E ata që nuk besuan argumentet e All-llahut dhe takimin me Të, të tillët kanë humbur shpresën nga mëshira Ime dhe ata i pret dënimi i hidhur. (Sure Ankebut: 23)

O besimtarë, mos i bëni miq ata njerëz me të cilët Allahu është i zemëruar. Ata e kanë humbur shpresën për jetën tjetër, ashtu siç e kanë humbur shpresën jobesimtarët për të varrosurit (se do të ringjallen). (Sure Mumtehine: 16)

PSE I FRIKËSOHEN BESIMTARËT ALLAHUT

Për të kuptuar se pse besimtarët i frikësohen Allahut, është shumë me rëndësi të kuptohet se frika ndaj Allahut është një ndjenjë e cila nxitë besimin, etjen, dashurinë e një besimtari për Allahun. Kjo frikë e ruan një person ndaj përvetësimit të qëndrimeve me të cilat nuk është i kënaqur Allahu, mban nën fre dëshirat e tepërta të unit dhe mbizotëron të këqijat e pafund. Kur të përjetohet nga një perspektivë pozitive, kjo frikë nxitë vazhdimisht vepra dhe qëndrime të mira.

Kjo frikë e largon besimtarin nga ndëshkimi i Allahut dhe e joshë atë drejt kënaqësisë dhe mëshirës së Allahut, gjë që rezulton me një kënaqësi të madhe shpirtërore. Ajo frymëzon tek besimtari nevojën për të respektuar kufijtë e Allahut, i jap atij një vendosmëri të paepur në kërkimin e kënaqësisë së Allahut dhe një syçeltësi konstante. Rrjedhimisht, frika e një besimtari në këtë dynja do ta shpëtojë atë nga frika e Ditës së Fundit dhe nga frika dhe vuajtja e përjetshme e Xhehenemit. Një ajet Kuranor shpall:

Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen. (Sure Bekare: 274)

Besimtarët që u frikësohen paralajmërimeve dhe ndëshkimit të Allahut dhe të cilët i binden me kujdes absolut urdhrat dhe gjykimit të Tij do të kenë një moral superior, të cilin e pranon Allahu: të modestisë, tolerancës, kujdesit, devotshmërisë, një intelekt të pastër dhe vetëdije të thellë për përsosmërinë e

pakrahasueshme të krijimit të Allahut. Njerëzit e tillë do të shfaqin sjellje shembullore dhe do të kenë vetëdije të lartë dhe ndjeshmëri të madhe. Në thelb, frika ndaj Allahut pasuron shpirtërisht besimtarin. Ajo e ngrit vizionin shpirtëror dhe lind një gjendje fisnike shpirtërore të forcuar nga aludimet e ndjeshme të dijenisë hyjnore; ky është çelësi i shpërblimit dhe lumturisë së përjetshme.

Ata i frikësohen pozitës së lartësuar të Allahut

Një besimtar që posedon për Allahun vetëdije ashtu siç përshkruhet në Kuran dhe i cili mendon sinqerisht për vetitë e Tij do të fillojë menjëherë të përjetojë atë frikë-respekt të brendshëm që e meriton pozita dhe superioriteti i Allahut. Madhështia, pafundësia dhe fuqia e pafund e Allahut do të krijojnë në qenien e besimtarit një frikë përplot respekt dhe mahnitje absolute.

Kjo frikë është një frikë e natyrshme, e cila rritet në zemrën e një besimtari i cili është i vetëdijshëm për pozitën e lartë dhe madhështore të Allahut. Shkallët e kësaj frike do të rriten në përpjestim me forcën e besimit të një personi dhe aftësinë e të menduarit. Kuran kësaj frike i referohet si *hashiat* (të kesh frikë-respekt).

Allahu është poseduesi i fuqisë së pafund, dijenisë së pafund dhe posedon urtësi të pafund. Ai bën çfarë të dojë kur të dojë Ai. Ai nuk do të pyetet për atë që Ai vepron, por ai do t'i marr në pyetje njerëzit lidhur me atë që ata kanë vepruar. Zoti ynë është i pasur përtej nevojës për çfarëdo qenie. Mirëpo, i tërë krijimi varet prej Tij. Çdonjëri dhe çdo gjë është krijuar nga asgjëja dhe është Allahu i Cili siguron ekzistencën e tyre. Ai është pronari i çdo gjëje dhe i çdokujt. Po të dëshironte Ai, do të mund të asgjësonte çdokënd dhe t'i zëvendësonte ata me krijesa tjera. Ai nuk harron kurrë asgjë. Nëse Allahu dëshiron që diçka të bëhet, Ai vetëm i thotë: “bëhu“ dhe ajo bëhet. Asgjë s'mund ta lodhë atë asnjëherë. As nuk vjen në shprehje që një person i zgjuar të përvetësojë një qëndrim mospërfillës ndaj Allahut as edhe për një moment të vetëm, e të mos flasim për marrjen e një qëndrimi kryengritës ndaj Tij superioriteti i të Cilit është i pafund.

Një person i cili e njeh Allahun ashtu siç përshkruhet në Kuran dhe i cili e vlerëson fuqinë e Tij do të jetë i pushtuar me frikë-respekt nga pafundësia e Tij dhe do të përvetësojë një qëndrim përlules dhe të kujdesshëm që Ai e meriton. Një besimtar i cili e di madhësitinë, madhërinë dhe fuqinë e Allahut është po ashtu i vetëdijshëm për vetitë tjera të Tij si “Hakmarrësi” “Imponuesi” “Ndëshkuesi” dhe “Përlulesi”. Ai do të dijë po ashtu se cilido qëndrim apo fjalim i cili është në kundërshtim me urdhrat e Tij nuk do të mbetet pa përgjigje nga Ai. Besimtari do të veprojë sipas dijes se Allahu është gjithnjë në dijeni për çdo gjë, që Ai është që përfshin dhe rrethon gjithçka dhe se Ai është më afër tij se sa damari i qafës së tij.

Si rezultat i sinqeritetit të besimtarit, Allahu do ta shpërblejë atë me Mëshirën e Tij të pafund me miratim në këtë botë dhe me Xhenet në Ahiret:

Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte! (Sure Rrahman: 46)

Është më se e sigurt se, për ta vlerësuar Allahun ashtu siç e meriton Ai, është e domosdoshme që njeriu të posedoj kuptim shumë të mirë të argumenteve (ajeteve) të Tij Kurane, si edhe të jetë në gjendje të njoh argumentet e Tij në botën fizike. Prej atomit apo qelizës më të vogël e deri te yjet apo galaktikat më të mëdha, posedimi i diturisë së hollësishme lidhur me krijimin e Allahut forcon frikën e një personi ndaj Tij. Duke qenë i vetëdijshëm për këto gjëra njeriu arrin të vlerësojë më mirë urtësinë, fuqinë dhe diturinë e pafund të Allahut ashtu si manifestohen ato në kompleksitetet e gjërave të panumërta që Ai ka sjellë në jetë, dhe njeriu po ashtu më lehtë mund të kuptoj veçantinë absolute të fuqisë së Tij për të krijuar. Kjo pastaj do të shërbente si mjet për forcimin për shumë herë të frikës ndaj Allahut. Allahu këtë fshehtësi e zbulon në këtë mënyrë në Kuran:

Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës. (Sure Fatir: 28)

Ata u frikësohen paralajmërimeve të Allahut

Në një ajet tjetër Allahu këshillon besimtarët t'ua kenë frikën paralajmërimeve të Tij ashtu siç do të kishin frikë ndaj pozitës së lartësuar të Tij:

Kjo është për ata që kanë frikë nga qëndrimi para Meje (për gjykim) dhe i tremben premtimit (dënimit) Tim.” (Sure Ibrahim: 14)

Allahu u ka premtuar atyre të cilët nuk besojnë dhe nuk i binden Atij, të cilët nuk marrin kurrë parasysh atë me të cilën është i kënaqur Ai dhe të cilët nuk i pranojnë urdhrat dhe ndalesat e Tij, një ndëshkim shpirtëror dhe fizik të pafund. Një besimtar i vërtetë e di se askush në këtë botë nuk është i sigurt nga ndëshkimi i Allahut. Për këtë arsye ai frikësohet nga të qenit i nënshtuar ndëshkimit të padurueshëm dhe të pafund të Xhehenemit, të cilin Allahu ua ka premtuar atyre të cilët hedhin poshtë besimin. Gjendja shpirtërore e besimtarëve të vërtetë përshkruhet në Kuran në këtë mënyrë:

[Besimtarë janë] ata që besojnë në Ditën e Llogarisë (Gjykimit); e që frikësohen nga dënimi i Zotit të tyre, vërtet që askush nuk është i sigurt prej dënimit të Zotit të vet. (Sure Me‘arixh: 26-28)

Shpirtrat e atyre besimtarëve që vërtetë i frikësohen Allahut dridhen me të dëgjuar të këndohen ato ajete të Kuranit të cilat i referohen Zjarrit. Në anën tjetër, ata të cilët refuzojnë të besojnë nuk mund të kuptojnë si duhet domethëniet e Librit të Allahut, madje edhe nëse e lexojnë atë. Prandaj, vetëm besimtarët e sinqertë do ta kuptojnë në këto ajete Kuranore paralajmërimin e Allahut drejtuar atyre për mundimet e Xhehenemit. Të vetmit njerëz të cilët do të jenë të kujdesshëm ndaj Kuranit, duke iu frikësuar ndëshkimit të Allahut dhe të cilët veprojnë në mënyrë të kujdesshme, janë besimtarët e sinqertë. Si rezultat i kësaj, ata nuk marrin për shembull njerëzit tjerë, por vetëm besimtarët që ia kanë frikën Zotit të cilët janë të lavdëruar në Kuran, dhe profetët.

Këta njerëz nuk bëhen mendjemëdhenj apo me besim të tepruar në vetvete, që mendojnë në vete: “këto ajete nuk mundën kurrësi të vlejnjë për mua, pasi që unë jam një besimtar.” Përkundrazi, si rezultat i besimit të tyre, ata

vazhdimisht do të shpresojnë për shpërblimin dhe mëshirën e Allahut, siç theksohet në ajetin në vazhdim:

... duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa... (Sure Sexhde: 16)

Lidhur me këtë çështje, Profeti Muhammed (savs) ka thënë:

“Kur zemra e një besimtari të jetë mbushur me këto dy ndjenja të shpresës dhe frikës, Allahu i Gjithëfuqishëm ia plotëson shpresën e tij dhe e shpëton atë nga ajo që ai frikësohet.” (Ibn Maxha)

Paralajmërimet dhe përkujtime të panumërta të Allahut mund të gjenden në Kuran në mënyrë që t’i mbrojnë njerëzit nga Xhehenemi. Me shpresë se mohuesit mund të bëhen prej atyre që frikësohen dhe të bëhen të kujdesshëm për sjelljen e tyre, ata janë paralajmëruar me ndëshkimet me të cilat do të përballen në Ahiret. Kjo theksohet në Kuran:

...“Të humburit e vërtetë janë ata që do të humbin veten dhe familjen e tyre në Ditën e Kiametit. Ja, kjo është humbja e qartë”! Ata do të mbulohen me shtresa zjarri nga sipër dhe nga poshtë. Me këtë, Allahu i tremb robërit e Vet. “O robërit e Mi, më kini frikë Mua!” (Sure Zumer: 15-16)

E vërteta është se Allahu ka paralajmëruar njerëzit, ose përmes ajeteve të Tij ose me ndërmjetësimin e profetëve të Tij apo madje edhe përmes ngjarjeve të veçanta të cilat ndodhin si përvoja paralajmëruese. Ai do t’i thërras ata dhe do t’i frikësojë me ndëshkimin e Tij. **... Dhe Ne i frikësojmë (paralajmërojmë) ata, por kjo vetëm u shton mohimin e madh.** (Sure Isra’ : 60) tregon se për ata të cilët me këmbëngulje e refuzojnë besimin, paralajmërimet e Allahut nuk bëjnë dobi, por i nxitë ata edhe më shumë ndaj mizorisë edhe më të madhe. Kur të vjen koha, ndëshkimi që e kanë mohuar ata do të shfaqet si e vërtetë e padyshimtë. Allahu shpall në njërin prej ajeteve të Tij:

Mjerë për ty! Mjerë për ty! Sërisht: Mjerë për ty! Mjerë për ty! Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri? (Sure Kijame: 34-36)

Atyre që iu shmangën frikës ndaj Allahut gjatë qëndrimit të tyre në Tokë dhe që mohuan ndëshkimin e Allahut, do t'u jepen librat e tyre nga ana e tyre e majtë pasi që të jenë thirrur për të dhënë llogari, në të cilën kohë ata do të gjykoohen sipas veprave të tyre dhe do të dënohen me ndëshkim të përjetshëm dhe do të shtyhen në Xhehenem në grupe. Ata do të jenë në një gjendje të rrënimimit të plotë psikologjik kur të tërhiqen zvarrë për tek dyert e Xhehenemit. Allahu përshkruan këtë moment në ajetet e Tij në këtë mënyrë:

Jobsimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehenem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij dhe rojtarët do t'u thonë atyre: “A nuk ju kanë ardhur të dërguar midis jush, të cilët ju lexonin shpalljen e Zotit tuaj e ju tërhiqnin vërejtjen për takimin e kësaj dite?!” Mohuesit do të thonë: “Po, është e vërtetë!” E kështu përmbushet fjala e Allahut për dënimin e mohuesve. Atyre u thuhet: “Hyni në portat e Xhehenemit, ku do të qëndroni gjithmonë!” Sa vend i shëmtuar që është ai për mendjemëdhenjtë! (Sure Zumer: 71-72)

Në këtë mënyrë, ata do të hyjnë nëpër dyert e Xhehenemit për të mbetur aty përgjithmonë. Dyert e Xhehenemit do të mbyllën dhe do të kyçen. Aty nuk do të ketë asnjë mundësi për të ikur dhe trupat dhe shpirtrat e tyre do t'i nënshtrohen një dhimbje të pafund dhe të padurueshme. Megjithatë, asnjëra prej ndëshkimeve të cilave do t'u nënshtrohen ata nuk do t'i mbytet ata. Pas çdo ekspozimi ndaj Zjarrit mishi i djegur i tyre do të ripërtërihet dhe ndëshkimi do të vazhdojë. Ata do të përvëlohen nga dëshira që ky ndëshkim të marr fund, por do të marrin këtë përgjigje:

Ata do të thërrasin: “O Malik! (Më mirë) Le të na vdesë Zoti yt!”, ndërsa Ai do të thotë: “Ju do të qëndroni përherë aty!” (Sure Zuhruf: 77)

Ndëshkimi i Xhehenemit është i llojeve të ndryshme, secili prej të cilëve tejkalon imagjinatën njerëzore. Të devijuarit do të jenë lënda djegëse e Xhehenemit, me të cilën ata do të mundohen. Fytyrat e tyre do të rrotullohen mbi Zjarrin e Xhehenemit, me duart e lidhura ata do të hidhen në një hapësirë të ngushtë në zjarr ku do të përvëlohen dhe damkosen. Ndërsa janë në këtë

gjendje ata do të fshikullohen me çomange të mbaruar prej hekuri, do të veshin këmisha prej katrani dhe do të flenë në shtretër prej zjarri të mbuluar me zjarr. Ata do të hanë prej një shkurre të hidhur dhe me gjemba dhe prej zekumit të helmuar dhe do të pinë gjak dhe qelb përvëlues. Uji i valë që ata do të detyrohen të pinë do t'ua shqyey zorrët, Zjarri do t'ua përcëllojë fytyrat, buzët e tyre do të tërhiqen prej dhëmbëve të tyre dhe ata do të rënkojnë e do të gulçojnë. Të gjitha këto janë vetëm një pamje të ndëshkimeve fizike në Xhehenem.

Banorët e Xhehenemit do t'i nënshtrohen po ashtu një dhimbjeje psikike të barabartë me dhimbjen fizike që vuajnë ata. Njëkohësisht ata do të ndihen të pafuqishëm, të dëshpëruar dhe do të ndiejnë keqardhje dhe do t'i nënshtrohen degradimit, turpërimit, poshtërimit, përruljes, zemërimit, tërbimit dhe grindjes. Në të njëjtën kohë, ndëshkimet që u shkaktohen atyre do t'i gllabërojnë dhe do t'i rrënojnë ata.

Nën këtë sulm të shumëfishtë të dhimbjes dhe vuajtjes, secili prej tyre do të jetë vetëm siç janë armiqët ndaj njëri tjetrit. Ata vazhdimisht do ta mallkojnë njëri tjetrin. Britma e tyre çmendur, të qarët, përgjërimi, rënkimi dhe ofshama e tyre do të shkrihen në një ulërimë shurdhuese.

Do të ishte e lehtë të imagjinohet se ata që i nënshtrohen këtij ndëshkimi janë krijesa të një lloji. Mirëpo, nuk është kështu, ata janë njerëz të cilët një kohë e banuan Tokën, të cilët ju mund t'i keni parë duke ecur në rrugë, disa prej të cilëve ju mund t'i njihni dhe dini personalisht. Asgjë nuk ka ndryshuar vetëm se në një kohë kur ata më së paku e pritën, engjëjt e vdekjes morën shpirtrat e tyre dhe e gjetën veten duke u përgjigjur dhe duke paguar për gjynahet që kanë bërë. Në mesin e krijesave të Allahut, vetëm besimtarët e vërtetë janë ata të cilët janë të vetëdijshëm për paralajmërimin e madh të Allahut dhe gjendja e të cilëve është ajo e frikës dhe shpresës:

(Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë) ata që thonë: "Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e Xhehenemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të është gjëja më e rëndë". (Sure Furkan: 65)

Ata i frikësohen humbjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut

Besimtari i vërtetë i cili posedon një dashuri të brendshme dhe të thellë për Allahun e di shumë mirë se ushqimi më i rëndësishëm për këtë dashuri është përsëri një frikë e brendshme, e thellë e cila është përplot respekt. Besimtarët e vërtetë, të cilët kanë shijuar kënaqësitë e papërsishkrueshme shpirtërore që sjell dashuria ndaj Allahut, frikësohen shumë nga bërja e çfarëdo të keqe apo gabimi që do të mund ta rrezikonte atë dashuri apo, edhe më keq, të ngjallte pakënaqësinë apo armiqësinë e Më të dashurit të tyre, Allahut.

Frika ndaj Allahut është e lidhur në mënyrë të ndërlidhur me dashurinë ndaj Allahut. Dashuria ndaj Allahut mund të arrihet vetëm me arritjen e afërsisë së Allahut, e cila bëhet realitet kur njeriu zhvillon një lidhje të afërt dhe të sinqertë me Të. Mirëpo, afërsia me Allahun nuk është e mundshme pa dashurinë dhe kënaqësinë e Tij dhe kjo arrihet duke iu përmbytur kufijve të përcaktuar prej Tij dhe duke përmbytur urdhrat e Tij. Kjo megjithatë, nuk është një gjendje që mund të arrihet pa rrënjosur së pari frikën ndaj Allahut, sepse shpirti i një personi i cili nuk i frikësohet Allahut do të jetë vazhdimisht i prirur ndaj bërjes së gjërave të cilat Allahu nuk i pëlqen dhe do të jetë i pavëmendshëm dhe mospërfillës ndaj atyre gjërave të cilat Allahu i kërkon prej neve. Për këtë arsye e vetmja rrugë për të fituar kënaqësinë e Allahut është përmes frikës ndaj Tij.

Kjo renditje e gjërave është përcaktuar nga Allahu. Andaj, të paramendohet se njeriu do të fitojë dashurinë dhe kënaqësinë e Tij para se njeriu të ketë mësuar frikën ndaj Tij është një shenjë e një vet-mashtrimi të madh. Para së gjithash, Allahu i ka urdhëruar njerëzit që t'ia kenë frikën Atij. Të mos zbatohet ky urdhër dhe të thuhet se njeriut i nevojitet vetëm ta dojë Allahun nuk ka kuptim. Njerëzit të cilët pohojnë se e duan Allahun përderisa mbeten mospërfillës ndaj asaj me të cilën Ai mund të jetë i pakënaqur janë, në të vërtetë, duke e mashtruar vetveten në përpjekjet e tyre për të qetësuar ndërgjegjet e tyre. Dashuria ndaj Allahut të cilën ata e përmendin është një pjellë e imagjinatës së tyre dhe është një gjë sipërfaqësore për nga natyra.

Njerëzit të cilët e duan Allahun me të vërtetë, janë jashtëzakonisht të përpiktë dhe të vendosur kur bëhet fjalë për besnikërinë e tyre ndaj urdhrave dhe ndalesave të Tij. Argumentimi se frika ndaj Allahut është e panevojshme në të vërtetë nuk dallon nga thënia: “nuk ka nevojë për agjërim, falje dhe adhurim.” Të tillët gjejnë prehje në shfaqësime të llojllojshme jo vetëm lidhur me çështjen e frikës ndaj Allahut por gjithashtu për t’iu shmangur përmbushjes së shumë urdhrave të tjerë të Allahut.

Ata e dinë se Allahu mund t’i ndëshkojë ata edhe në Tokë

Kurani përmban përplot referenca lidhur me ndëshkimin e Allahut ndaj disa njerëzve si rezultat i gjynaheve që ata kanë bërë në Tokë. Përkundër faktit që Allahu u ka ofruar atyre mundësi të bollshme për t’iu shmangur atij, ata të cilët kanë këmbëngulur në mohimin e tyre të besimit kanë vuajtur pasojat e përgjigjes së Allahut përderisa ishin ende në Tokë për atë që kanë punuar dhe kanë mbetur si shembuj kryesor për të tjerët.

Një shembull parësor lidhur me këtë është historia e Karunit, të cilit i ishte dhuruar pasuri e madhe nga Allahu. Kjo pasuri e madhe ishte pasojë që ai të bëhej mendjemadh dhe të zhvillojë një ndjenjë të vetëbesimit të tepruar. Njerëzit fillimisht ishin të bindur për fuqinë e madhe të Karunit dhe kishin një admirim të madh për të, mirëpo, më vonë, kur ai u ndesh me vdekjen e tij si pasojë e krenarisë së tij të fortë, ata më në fund e kuptuan të vërtetën. Karuni u shkatërrua në një mënyrë tërësisht të papritur dhe të pashembullt si pasojë e drejtpërdrejt e mosbindjes së tij dhe e bëri atë objekt të qartë mësimi që ta mësojë mbarë njerëzimi:

Kur ai dilte para popullit të vet me stolitë e tij, ata që lakmonin jetën e kësaj bote thanë: “Ah! Sikur të na ishte dhënë edhe neve si Karunit! Vërtet që ai është njeri me fat.” (Sure Kasas: 79)

Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t’i gëlltiste toka dhe askush nuk

arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten. Të nesërmen, ata që më parë dëshironin të kishin qenë në vend të tij, thoshin: “Është shumë e qartë se Allahu është Ai që i jep bollëk dhe ia pakëson kujt të dojë prej robërve të Tij. Sikur Allahu të mos kishte mëshirë për ne, me të vërtetë që do të na kishte bërë të na gëlltiste toka. Ububu! Është shumë e qartë se mohuesit nuk kanë shpëtim!” (Sure Kasas: 81-82)

Historia e Karunit dhe të dhënat tjera në Kuran për shumë bashkësi madhështore dhe të fuqishme që nuk kanë mundur të mbrojnë veten e tyre nga ndëshkimi i Allahut tërheqin vëmendjen në veçanti ndaj faktit se Allahu i ka ndëshkuar ata këtu në Tokë. Kjo e vërtetë shpjegohet në shumë ajete Kuranore:

Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta... (Sure Rum: 9)

...Vallë, a nuk e dinte ai, se Allahu kishte zhdukur para tij shumë brezni, që kishin qenë më të fuqishëm dhe që kishin grumbulluar më shumë pasuri se ai?... (Sure Kasas: 78)

Por sa e sa brezni, që kanë qenë më të begatshëm dhe më të pashëm, Ne i kemi shkatërruar para tyre! (Sure Merjem: 74)

Ajo që e dallon një besimtar të vërtetë nga njerëzit tjerë është vetëdija e tyre për gjithë këto çështje, ata ndiejnë frikën e Allahut me një frikë-respekt të brendshëm dhe sillen në mënyrë të kujdesshme. Kur ata bëjnë ndonjë gabim apo bëjnë një vepër të gabuar, ata janë të vetëdijshëm se Allahu mund t’u jap përgjigje të menjëhershme dhe kështu ata i drejtohen Atij në një gjendje keqardhjeje dhe pendimi, duke e lutur Atë për falje.

Një besimtar i vërtetë i frikësohet shumë Allahut por në të njëjtën kohë e vënë besimin e tij në mëshirën e pafund të Allahut. Kjo ndjeshmëri vjen thjesht si rezultat i të menduarit për Ahiretin.

Allahu përmend në Kuran ata njerëz të cilët kanë një qëndrim krejtësisht të

kundërt. Edhe pse ndëshkimi që do të pasojë është i shfaqur qartë për t’u parë, ata dështojnë që ta lidhin atë me realitetin e gjendjes së tyre të vështirë dhe këmbëngulin në sjelljen e tyre të gabuar. Gjendja e tyre në Kuran përshkruhet si vijon:

Dhe kur panë një ré që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: “Kjo re po sjell shiun!” “Jo!” – u përgjigj ai – “kjo është ajo që ju e keni shpejtuar: një erë që mbart një dënim të dhembshëm, që, me urdhrin e Allahut, shkatërron çdo gjë.” E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre të zbrazëta; ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës. (Sure Ahkaf: 24-25)

Si përfundim kur i hedhim një vështrim Kuranit shohim se veprat e këqija, derisa njeriu që i kryen ato nuk pendohet dhe nuk pushon së vepruari menjëherë ashtu siç kërkon drejtësia e lartësuar e Allahut, nuk kalojnë të pandëshkuar. Megjithatë, ky ndëshkim nganjëherë arrin njerëzit këtu në Tokë dhe ndonjëherë shfaqet në Ditën e dhënies së llogarisë. Ata që shfaqin mosmirënjohje dhe që këmbëngulin në atë që e veprojnë, nuk janë kurrë të sigurtë nga ndëshkimi që Allahu mund ta dërgoj mbi ta për një çast të vetëm. Kjo e vërtetë në Kuran përshkruhet si vijon:

Vallë, a jeni të sigurt, që Ai nuk do t’ju fundosë në tokë ose, që nuk do të dërgojë mbi ju stuhi me rërë, pa pasur mundësi që ju të gjeni dikë, që t’ju mbrojtë? Apo jeni të sigurt, që Ai nuk do t’ju kthejë ju përsëri (në det)

e, që nuk do t’ju dërgojë furtunë e t’ju fundosë për shkak të mosbesimit tuaj, pa pasur mundësi që të gjeni dikë, që t’ju mbrojtë nga Ne? (Sure Isra’: 68-69)

Profeti Muhammed (savs) shpreh drejtësinë e lartësuar të Allahut si vijon: *“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, duhet të urdhëroni atë që është e ndershme dhe të ndaloni atë që është e pandershme, ose Allahu padyshim se do të dërgojë mbi ju ndëshkim prej Tij. Atëherë ju do të luteni por nuk do të merrni përgjigje.” (Tirmidhiu)*

Njerëzit nuk mund të jetojnë gjithë jetën e tyre në mënyrë të papërgjegjshme, sepse ata janë përgjegjës ndaj Allahut. Të shkohet kundër kësaj do të thotë të shkaktohet ashpërsia e ndëshkimit të Allahut. Të vazhdohet me vetëdije me një sjellje të tillë është dëshmi e qartë e dështimit për të vlerësuar fuqisë gjithëpërfshirëse të Allahut. Po të donte Allahu, Ai do të mund të tërhiqte në çdo moment të gjitha mirësitë që Ai ia ka dhuruar njerëzimit. Këtij fakti i referohen ajetet Kuranore të cituara më poshtë:

Sikur të donim, Ne do t'ua verbonim atyre sytë, kështu që ata do ta kërkonin më kot rrugën! Vallë, si do të shihnin? Sikur të kishim dashur, Ne do t'i kishim shndërruar ata (në krijesa të tjera) në atë vend e ata nuk do të mund as të shkonin e as të ktheheshin. (Sure Ja Sin: 66-67)

E vërteta është se çdo gjë që posedon një person, çdo frymëmarrje, çdo sekondë të jetës së tij ia ka borxh Allahut, dhe pasiqë besimtarët e sinqertë janë të vetëdijshëm për këto të vërteta ata janë vazhdimisht të kujdesshëm për të mos i tejkaluar kufijtë e Allahut.

Ata i frikësohen të qenit të zënë të papërgatitur nga vdekja

Vdekja është një realitet. Mesatarisht, një person do të qëndrojë në Tokë për rreth gjashtëdhjetë vite pas të cilave fillon jeta e përjetshme. Kjo jetë e përjetshme do të jetohet ose në Kopshtin (Xhenetin) e pajisur me mirësi të panumërta, ose në Zjarrin (Xhehenemin), i cili është krijuar posaçërisht për t'i shkaktuar dhimbje trupit dhe shpirtit. Kurdo që Allahu dëshiron, Ai mund t'i jap fund jetës së një personi në Tokë dhe ta dërgojë atë në Ahiret dhe nuk ka dyshim se ky vendim mund të bëhet realitet sa çel e mbyll sytë.

Një person nuk mund ta dijë kurrë se kur do të vdes, kohën kur do të përfundojë sprovën e tij apo momentin e gjykimit të tij përfundimtar. Për këtë arsye ai duhet të ketë frikë dhe të jetë i kujdesshëm për t'mos u zënë i papërgatitur kur të vjen ai moment, kur s'do të ketë mundësi të jap llogari për veprimet e tij dhe kur do të jetë i ngarkuar me detyrime që ai ose i ka shpërfillur

ose i ka shtyrë për më vonë dhe nuk i ka marr seriozisht. Kur engjëjt e vdekjes vijnë nuk ekziston më asnjë mundësi për të përmbushur detyrimet e papërfunduara apo për të kompensuar punën që është dashur të kryhet. Veprat e bëra deri në atë moment do të shërbejnë ose për përfitimin ose për humbjen e njeriut dhe njeriu do të thirret të jap llogari dhe do të mbajë përgjegjësinë për to apo do të shpërblehet për to, sipas rastit.

Vdekja është një realitet nga i cili nuk ka kthim. Çdo njeriu i lejohej të **“jetoj aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)”** (Sure Fatir: 37). Kur të vjen koha e përcaktuar e vdekjes, pa marr parasysh se sa përgjërohet apo lutet një person atij nuk do t’i jepet një mundësi tjetër. Atij nuk do t’i dhurohet kohë shtesë për të përmbushur përgjegjësitë e tij ndaj Allahut që ai nuk i kishte përmbushur deri në atë kohë. Allahu i ka porositur besimtarët e sinqertë për të parandaluar që ata të bëhen të pavëmendshëm dhe mospërfillës:

Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!” Por Allahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju. (Sure Munafikun: 10-11)

Njerëzit nuk duhet kurrë të jenë të kënaqur me vetveten dhe me atë që kanë bërë përderisa janë të vetëdijshëm që vdekja mund të bëhet realitet në çdo moment dhe për të mos qenë të papërgatitur për një përfundim që nuk ka kthim. Njeriu duhet të kaloj çdo moment duke u përpjekur për t’iu përmbajtur kufizimeve të përcaktuara prej Allahut.

Ata i frikësohen Ditës së Gjykimit

Frika ndaj Allahut dhe Dita e Gjykimit e ushqyer prej atyre që posedojnë besim përshkruhet në ajetin vijues Kuranor:

Që i frikësohen Zotit të tyre - edhe kur nuk i sheh askush dhe, që i tremben Orës (së Kiametit). (Sure Enbija: 49)

Veç kësaj, në një tjetër ajet Kuranor Allahu përmend frikën e brendshme të besimtarëve:

Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes dhe mbrëmje, njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zeqatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara. (Sure Nur: 36-37)

Si për njerëzit të cilët kanë qëndruar të larguar nga frika ndaj Allahut gjatë gjithë jetës së tyre, ashtu edhe ata të cilët kanë besuar dhe janë sjellë në mënyrë të kujdesshme, punët e tyre të dynjasë do t'ju tregohen atyre një nga një. Për më tepër, pa lënë jashtë madje as edhe hollësinë më të vogël, atë ditë ata të cilët kanë jetuar një jetë të papërgjegjshme pa iu frikësuar Allahut dhe duke vepruar në mënyrë të pakujdesshme do të kuptojnë se për ku janë përcaktuar:

Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë. (Sure Zelzele: 6-8)

Si rezultat i frikës dhe pendimit të tyre, ata do të duan të vdesin dhe të mos ekzistojnë fare. Ekzistenca e tyre e rrënuar përshkruhet në ajetin vijues të Kuranit:

Por ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: "Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!" (Sure Hakka: 25-29)

Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet, sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari). Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij! (Sure Inshikak: 10-15)

Pas kësaj, veprat që përmbajnë arkivat individuale do të peshohen në peshore të ndjeshme, të cilat Allahu i ka përgatitur për Ditën e Gjykimit. Nuk do të bëhet padrejtësi as edhe sa pesha e një atomi të vetëm. Nëse njeriu nuk është në mesin e atyre që ishin të kujdesshëm, peshorja e tij do të jetë e lehtë dhe ai do të kapet, do të lidhet në zinxhirë dhe do të dërgohet në vendin të cilin e meriton. Jo vetëm që s' do t' i ndihmoj askush askujt tjetër, njeriu s' do të jetë në gjendje t' i ndihmoj as edhe vetes së tij. Dhimbja që do të shkaktoj mosqenia në gjendje t' i ndihmoj vetvetes do ta pushtojë tërë qenien e njeriut:

E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit). Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehenemit)? Ajo është një Zjarr i vrullshëm. (Sure Kari'a: 8-11)

Atë ditë, njerëzit që jetuan jetën e tyre në Tokë pa frikë ndaj Allahut do t' i kenë të gjitha gjynahet e tyre të paraqitura para tyre një nga një. Jo vetëm veprat e bëra por gjithashtu edhe veprat e këqija të cilat mund t' i ketë pasur për qëllim t' i bëj. Kur të vjen ajo kohë ata nuk do të jenë në gjendje të bëjnë asgjë për pendimin që do të përjetojnë. Madje edhe përpjekjet e tyre të mohimit do të dështojnë pasi që të dëgjuarit, shikimi dhe lëkura e tyre do të fillojnë të flasin dhe të dëshmojnë kundër tyre siç urdhërohen prej Allahut:

Do të vijë dita (e Kiametit), kur mohuesit do të dëshirojnë që të ishin myslimanë. (Sure Hixhr: 2)

Frika që ndien besimtari i vërtetë siguron që ata të vazhdojnë të sillen në mënyrë të kujdesshme dhe të ndërgjegjshme, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm që ajeti i Allahut do të zbulohet atë ditë. Kjo është arsyeja pse për aq kohë sa qëndron njeriu në Tokë duhet të jetë syhapur që të mos përfshihet në çfarëdo për të cilën njeriu s' mund të jap një llogari të pranueshme. Në të vërtetë, është e papërfytyrueshme që një person që posedon mendje të shëndoshë të mund të vepronte në kundërshtim me këtë. Dituria e Allahut është

gjithandej dhe rrethon e përshkon gjithçka. Ai është më afër njeriut se që është damari i qafës së tij, ndërsa engjëjt me detyrë të posaçme regjistrojnë çdo gjë pa harruar as edhe hollësinë më të vogël. Pakujdesia më e madhe e mundshme është që një person të preokupohet me çështjet e pavlerë dhe të kalueshme të kësaj bote me çmimin e harresës së Ditës së Gjykimit.

Që nga momenti kur hapim sytë në mëngjes do të thotë se Allahu ka krijuar një ditë të re dhe një mundësi tjetër për ne. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm për momentin kur do t'i japim llogari Allahut dhe të fillojmë ditën me qëllime të singërta. Mirëpo, qëllimi ynë duhet të jetë që të largojmë vetveten nga sjellja dhe veprimet të cilat Allahu nuk i pëlqen. Askush s' do të dëshironte të gjendet në mesin e atyre të cilët kur të vjen ky moment do të kapen dhe do të dërgohen në një ndëshkim të pafund duke qarë: “Vetëm sikur ...” dhe “sa do të dëshiroja...”

O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t'ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t'ju mashtrojë për Allahun. (Sure Lukman: 33)

ÇFARË VLERA MORALE POSEDON NJË PERSON I CILI I FRIKËSOHET ALLAHUT?

*O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të
mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim;
por, petku i devotshmërisë është më i miri.*

*Këto janë disa shenja të Allahut,
që ju të merrni këshillë.*

(Sure A'raf: 26)

I ë shumë ajete të Kuranit janë dhënë shumë shembuj të qëndrimeve dhe sjelljeve të besimtarëve të sinqertë të cilët kanë frikën e Allahut. Në dritën e këtyre shembujve vlerat themelore morale që i posedojnë ata të cilët kanë frikën e Allahut do të ekzaminohen më poshtë.

Ata i frikësohen vetëm Allahut

Në pajtim me ajetin: “... **por atyre mos iu frikësoni, frikësohuni vetëm prej Meje -, që të plotësoj mirësinë Time ndaj jush dhe që ju të shkoni në udhë të drejtë.**” (Sure Bekare: 150), besimtari i sinqertë nuk i frikësohet askujt ose asnjë komuniteti pos Allahut. Ai do ta dijë se përfitimi dhe humbja, e mira dhe e keqja mund të vijnë vetëm prej Allahut, se të gjitha ngjarjet me të cilat ai do të ndeshet janë vetëm vullneti dhe krijimi i Allahut në pajtim me fatin e përcaktuar për të nga Allahu.

Kjo cilësi e veçantë mund të shihej tek të gjithë profetët të cilët ndërsa kumtonin fenë e Allahut ishin në të shumtën e rasteve të kundërshtuar nga kombe të tëra por nuk bënë madje as edhe lëshimin më të vogël. Allahu përmend këtë cilësi në ajetin e cituar më poshtë:

(Profetët janë) ata të cilët kumtuan shpalljet e Allahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij. Allahu mjafton si llogaritës. (Sure Ahzab: 39)

Një person i cili ka besim në Allahun do të pranoj dhe do të zbatoj për veten e tij shembullin e lartë të profetëve.

Ata përpiqen që ta kënaqin vetëm Allahun

Një besimtar i sinqertë e jeton jetën e tij me dijen se Allahu është gjykuesi i çdo gjëje, se Ai është i vetmi zotërues i pushtetit dhe fuqisë dhe se çdo gjë vjen në jetë me vullnetin e Tij. Për këtë arsye besimtarët e sinqertë do të dinë se të kërkosh miratimin e qenieve të krijuara të cilat, në realitet, nuk posedojnë pushtet dhe fuqi, sidoqoftë nuk sjellë kurrfarë dobie. Të kesh frikën e Allahut dhe të kërkosh kënaqësinë e Tij në këtë botë do të sigurojë mbrojtje nga ndëshkimi i tmerrshëm i Ahiretit.

Vallë, a mund të krahasohet ai që kërkon kënaqësinë e Allahut me atë që ka merituar zemërimin e Allahut dhe strehimi i tij është Xhehenemi?! Eh, sa strehim i keq është ai! (Sure Ali Imran: 162)

Do të arrijë koha kur çdo vepër, e madhe apo e vogël, do të zbulohet dhe kur duart dhe lëkura e një personi do të dëshmojnë kundër tij. Një besimtar i sinqertë e jeton jetën e tij në pajtim me këtë të vërtetë dhe absolutisht kurrë nuk do të bëj kompromise në çfarëdo rrethana.

Qëndrimi i Profetit Jusuf (Jozef) (as) është një shembull shumë i mirë. Profeti Jusuf (as) ishte në gjendje të ruaj dëlirësinë e tij ndaj një gruaje me pushtet e cila e dëshiroi atë. Përkundër të gjitha kërcënimeve dhe intrigave të

saj, ai parapëlqeu të futet në burg para se të tejkalonte kufijtë e Allahut. Allahu na bën me dije për fuqinë superiore të karakterit të Jusufit (as) në Kuran:

Ajo tha: “Jo, ky është ai për të cilin ju më qortuat. Jam përpjekur ta josh, por ai është ruajtur nga gjynahu. Por, nëse ai nuk bën atë që e urdhëroj unë, me siguri që do të burgoset dhe do të poshtërohet”. Ai tha: “O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).” (Sure Jusuf: 32-33)

Ata veprojnë gjithnjë në mënyrë të ndërgjegjshme

Një person i cili është rob i Allahut nuk do t'i vendos nevojat dhe dëshirat e tij mbi pritjet e Zotit të tij. Ai e din se nëse vepron në këtë mënyrë duke e ditur të vërtetën, ai mund të pësojë ndëshkimin e Allahut në tokë dhe në Ahiret. Për sa kohë që është i vetëdijshëm për këtë rrezik, ai do të jetë i sigurt që të mos shpalojë atë lloj sjelljeje që do ta sillte atë brenda çarkut të ajeteve të cituara më poshtë:

Por, keqbërësit, nga padituria ndjekin qejfet e veta. Atëherë, kush do ta udhëzojë atë që e ka lënë të humbur Allahu? Për njerëz të tillë nuk ka kurrfarë ndihmësi. (Sure Rum: 29)

Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh? (Sure Xhathije: 23)

Ata imitojnë të gjitha cilësitë e mira të përshkruara në Kuran

Një person i cili i frikësohet Allahut do të shfaq ato qëndrime që lidhen me karakterin e mirë siç janë besnikëria, besimi, drejtësia, ndershmëria dhe sinqeriteti. Kurani përmend shpesh besimtarët e sinqertë të cilët shfaqin tipare

superiore të karakterit. Ata janë shembuj të sjelljes së njerëzishme që të gjithë besimtarët duhet të përpiqen të imitojnë. Megjithatë, derisa dikush nuk e ka frikën e Allahut, ata nuk mundën kurrë të vlerësojnë realisht këto veçori sepse në momentin që ndeshen me një konflikt interesi ata pashmangshmërisht do të fundosen në nivelin e përfitimit të tyre të menjëhershëm, në vend se të ngriten në nivelin e sjelljes më të mirë siç përshkruhet në Kuran. Ata thjeshtë nuk janë në gjendje të përjetojnë llojin e shqetësimit për pakënaqësinë e Allahut, apo për të qenit përgjegjës ndaj Tij, apo për futjen në Xhehenem dhe përballjen me pasojat e sjelljes së tyre të keqe, që do t'ua bënte të mundshme atyre që të sillen më mirë.

Ata respektojnë ndalesat e Allahut edhe nëse askush nuk i shikon

Dikush i cili është thellësisht i vetëdijshëm për Allahun përsëri do të jetë tejet i kujdesshëm që të mos bëj çfarëdo qoftë që nuk do t'i pëlqente Atij, pa marr parasysh nëse dikush është i pranishëm apo jo, sepse ata janë të vetëdijshëm se çdo lloj gjynahu që ata bëjnë Allahu do të dijë për të, pa marr parasysh se a është bërë haptas apo fshehurazi. Allahu e din edhe të dukshmen edhe të fshehtën, madje edhe gjërat më fshehta dhe ato do të zbulohen dhe do të jepet përgjegjësi për to. Ata që janë plotësisht të vetëdijshëm për Allahun e din se Ai do t'i prezantoj ata me rrethana që kanë për qëllim të vënë në sprovë sinqeritetin e kujdesit të tyre. Në njërin prej ajeteve të Tij, Allahu i udhëzon besimtarët e sinqertë:

Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta, sepse, ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar.
(Sure En'am: 120)

Në çdo situatë ata i drejtohen Allahut

Besimtarët e vërtetë të cilët janë të vetëdijshëm dhe kanë frikën e Allahut janë jashtëzakonisht të ndjeshëm kur bëhet fjalë për marrjen e përgjigjes prej Tij. Kur atyre u ndodhë ndonjë ngjarje negative apo kur ndiejnë se puna po ju shkon keq, apo kur përfjethen ndonjë shqetësim, ata menjëherë do të kontrollojnë veten nëse kanë bërë apo jo diçka me të cilën Allahu nuk është i kënaqur. Me anë të lutjeve të tyre ata do të kërkojnë dhe do të luten për falje prej Tij. Kombinimi i dëshirës së tyre për të fituar kënaqësinë e Allahut me frikën që ndiejnë ata për mundësinë e shkaktimit të pakënaqësisë së Tij, është zhvilluar në një formë të lartë të perceptimit.

Në këtë aspekt, qëndrimi i Profet Davud (David) (as) përbën një shembull të shkëlqyeshëm. Respekti i thellë i treguar ndaj Allahut nga ana e Profetit Davud (as) në Kuran zbulohet me anë të ngjarjes në vazhdim siç rrëfëhet në Kuran:

A e ke dëgjuar historinë e dy kundërshtarëve, që hipën mbi murin e faltores së tij? Kur hynë te Daudi, ai u frikësua prej tyre. Ata thanë: “Mos u frikëso! Ne jemi dy kundërshtarë, një nga të cilët i ka bërë padrejtësi tjetrit, prandaj gjyko me drejtësi dhe mos u shmang (prej së vërtetës), por na udhëzo në rrugë të drejtë”. (Njëri prej tyre tha:) “Ky është vëllai im. Ai ka nëntëdhjetë e nëntë dele, kurse unë kam vetëm një dele, andaj më tha: “Ma jep mua atë!” - dhe më mundi me fjalë.” Daudi tha: “Vërtet, ai të ka bërë padrejtësi që të ka kërkuar delen tënde të vetme, për ta bashkuar me delet e veta. Shumë bashkëpronarë i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira, por ata janë pak”. Daudi e kuptoi, se në të vërtetë Ne e kishim vënë në provë atë, prandaj kërkoi falje nga Zoti i vet, ra në gjunjë dhe u përul, duke u penduar. Pastaj, Ne ia falëm këtë e ai te Ne do të jetë i afërt dhe do të ketë strehim të mirë (në jetën tjetër). (Sure Sad: 21-25)

Edhe pse vendimi i Profetit Davud (as) ishte plotësisht i drejtë dhe nuk kishte kurrfarë dyshimi për këtë, ai iu drejtua Allahut me frikë mos kjo shkaktonte pakënaqësinë e Allahut dhe prapëseprapë kërkoi faljen e Tij. Nuk është e mundur të imitohet një frikë e brendshme sikur kjo, e cila është e pastër dhe e sigurtë. Një vetëdije e tillë plot frikë-respekt është vetëm për ata të cilët e vlerësojnë Allahun ashtu si e meriton Ai, të cilët i frikësohen humbjes së kënaqësisë së Tij për shkak të dashurisë dhe frikë-respektit të tyre ndaj Tij.

Kur shohim sjelljen e profetëve dhe të besimtarëve të sigurtë, vërejmë se ata janë të gjithë robër të cilët i frikësohen Allahut me plot respekt dhe të cilët fuqishëm i shmangen ndëshkimit të Tij. Megjithatë, në të njëjtën kohë, prapa këtij frikë-respekti është e pranishme një dashuri dhe miqësi shumë intime. Lavdërimi dhe lartësimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i tyre i Allahut është një tregues për dashurinë dhe besnikërinë e tyre të plotë ndaj Tij.

CILËSITË QË FITON NJË BESIMTAR PËR ARSYE SE I FRIKËSOHET ALLAHUT

Një pozitë e lartë tek Allahu

... Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë. (Sure Huxhurat: 13)

Padyshim pozita e një personi tek Allahu do të jetë në pajtim me vlerësimin e tij të Allahut, sasinë e veprave të mira të tij, zbatimin e urdhrave të Kuranit nga ana e tij, mirësinë e karakterit të tij dhe sinqeritetin e besimit të tij. Pa një vetëdije plot frikë-respekt ndaj Allahut, njeriu nuk mund të përmbush këto cilësi të karakterit dhe mirësjelljes. Andaj, shkalla e frikës ndaj Allahut në zemrën e dikujt është një tregues themelor i pozitës së tij tek Allahu.

Aftësia për të bërë dallimin në mes të së drejtës dhe të gabuarës

O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t'ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t'ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t'ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe. (Sure Enfal: 29)

Aftësia për të bërë dallimin në mes të së drejtës dhe të gabuarës dhe forcimi i të kuptuarit që e shoqëron atë, janë padyshim, mirësitë më të mëdha dhe më të vlefshme që mund t'i dhurohen një besimtari të sinqertë në Tokë.

Nëse dikujt i dhurohet mençuria që të jetë i aftë të dalloj të drejtën nga e gabuara, secila fjalë e tyre, secili qëndrim i tyre, secili vendim i tyre dhe secili reagim i tyre do të jetë mendjemprehtë dhe i saktë. Pasi që dikush i cili i frikësohet Allahut mundet menjëherë të bëj dallimin në mes të së drejtës dhe të gabuarës, ata do të sillen në pajtim me atë që më së shumti e kënaq Allahun në çdo gjë që bëjnë. Ata nuk do të ndikohen nga pavendosmëria, pasiguria, ngurrimi, shqetësimi apo hutimi. Mirëpo në kundërshtim të plotë me këtë, ata të cilëve nuk u është dhënë aftësia për të bërë dallime janë të gënjyuar për shkatërrim, si në Tokë ashtu edhe në Ahiret.

Hisja e dyfishtë prej mëshirës së Allahut

O ju (ithtarë të Librit) që besuat (në Musain dhe Isain), ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij (Muhamedin), se Ai do t'ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t'ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t'ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë. (Sure Hadid: 28)

Në Kuran Allahu u premtan gjithë robërve të Tij të cilët i frikësohen Atij dhe sillen me maturi se jetët e tyre do të jenë të bekuara, si ajo e kësaj bote ashtu edhe ajo shpirtërore. Siç shprehet në ajetin Kuranor: “**...All-llahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë.**” (Sure Ma'ide: 119) Sepse një besimtar i sinqertë, që Allahu duhet ta përfshijë në mëshirën e Tij është padyshim mbi çdo gjë tjetër.

Nuk duhet harruar se gjatë jetës sonë në Tokë, Allahu mund të na dhuroj lumturi, begati, mirësi, rehati dhe siguri. Mirëpo, në Ahiret, ata të cilët i frikësohen Allahut do të shpërblehen me mëshirën e Tij të pafund dhe do t'ju dhurohen mirësi shumë më të mëdha, me të cilat ato në Tokë nuk mund të krahasohen kurrë.

Adhurimi i pranueshëm

Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. (Sure Ma’ide: 27)

Këtu njëri prej djemve të Profetit Adem (as) thotë se Allahu pranon sakrificën e atyre të cilët i frikësohen Atij. Dikush i cili nuk posedon frikën ndaj Allahut është, sipas këtij definimi, i paaftë të shpreh falënderimin që i takon plotfuqishmërisë së Allahut dhe nuk është në gjendje të ndiej respektin që duhet ta ndiej ndaj Tij. Si rezultat i pikëpamjes së tyre të shtrembëruar të ekzistencës dhe degjenerimit të pashmangshëm të karakterit dhe sjelljes që e shoqëron atë, përpjekjet e njerëzve të tillë thuaja se padyshim nuk do të kenë kurrfarë vlere në shikimin e Allahut. Për këtë arsye, Allahu kërkon mbi çdo gjë tjetër që karakteri i një individi të ndërtohet mbi vetëdijen plot frikë-respekt ndaj Tij dhe në kërkimin e kënaqësisë së Tij. Çdo qasje e mbështetur në mohimin e kësaj do të përfundoj padyshim me zhgënjim, siç tregohet në Kuran:

Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij apo ai që themelet e godinës së tij i vë në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës. (Sure Teube: 109)

Nuk ka mundësi që adhurimi i njerëzve të cilët nuk posedojnë vetëdije me frikë-respekt për Allahun dhe sjellja e të cilëve është e papranueshme, të jetë aq i devotshëm dhe i sinqertë siç duhet të jetë. Prapa çdo detyre apo akti të adhurimit që ata ndërmarrin do të qëndrojë gjithmonë dëshira për të dal në publik apo për të lënë përshtypje, apo për të projektuar një imazh më të mirë se të tjerët. Prandaj, çdo gjë që ata bëjnë gjatë jetës së tyre nuk do të ketë asnjë vlerë nëse nuk i drejtohen Allahut dhe nuk ndryshojnë sjelljen e tyre.

Gëzimi i lehtësisë në punët e njeriut

...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia lehtësojë çështjen. (Sure Talak: 4)

Allahu do t'ju mundësojë gjithnjë besimtarëve të sinqertë të cilët janë të ndërgjegjshëm për atë që shkakton pakënaqësinë e Tij dhe të cilët respektojnë kufijtë e Tij, të gëzojnë mëshirën, mbrojtjen dhe mëshirën e Tij. Ai do t'ju hap udhën atyre në të gjitha ndërmarrjet e tyre. Me fjalët e një ajeti tjetër Kuranor: “Dhe Ne do të ta lehtësojmë ty rrugën e drejtë.” (Sure A'la: 8) Allahu, haptas apo ndryshe, do t'ju lehtësojë punët robërve të Tij në çdo drejtim, qofshin ato të dynjasë apo shpirtërore.

Allahu siguron rrugëdalje nga vështirësitë

... Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) (Sure Talak: 2)

Për robërit e devotshëm të Allahut që ndiejnë frikë-respekt ndaj Tij, asnjë vështirësi nuk është asnjëherë e pazgjidhshme apo e pakalueshme. Me Allahun, ata janë të aftë të tejkalojnë çdo pengesë duke përdorur mençurinë dhe të kuptuarit me të cilat i ka pajisur Ai. Madje edhe në situatat në dukje më të vështira, Allahu në fund do t'ju tregoj rrugëdaljen atyre dhe sado që të zgjas vështirësia e tyre, ata nuk do të lihen vetëm. Ky është premtimi i Allahut për besimtarët.

Allahu shlyen veprat e tyre të këqija, i falë ata dhe e shumëfishon shpërblimin e tyre

Ja, këto janë urdhërimet që Allahu i ka zbritur për ju. Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia shlyejë veprat e këqija dhe do t'ia rrisë shpërblimin. (Sure Talak: 5)

Pas vdekjes së tyre kur ata thirren për të dhënë llogari, për besimtarët e sinqertë do të ketë një llogaridhënie të lehtë. Kjo për arsye se besimtarët kanë jetuar jetët e tyre në Tokë në pajtim me udhëzimin e Zotit tonë i Cili i krijoi ata.

Është e padyshimtë se ata nuk kanë gabime, ata mund madje të kenë bërë gjynahe por Allahu, zotëruesi i mëshirës së pafund, ka thënë në Kuran se Ai do t'i falë ata:

Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Sure Zumer: 53)

Prandaj, ata njerëz të cilët Allahu i ka falur do të fitojnë një shpërblim edhe më të madh për atë që kanë vepruar në Tokë; ata do të pranohen në Kopshtin i cili është përplot me mirësi të panumërta.

Dhembshuria e pafund e Allahut do t'ju demonstron besimtarëve të sinqertë madje edhe në Tokë. Si rezultat i kujdesit të tyre me frikë-respekt, dashurisë së tyre ndaj Tij dhe veprave të mira që i kanë bërë ata, shpërblimi për mirësinë dhe sjelljen e tyre të sinqertë do të rritet shumëfish. Edhe pse ata dosido detyrohen me borxhin e adhurimit dhe bindjes për jetën që Ai u ka dhuruar në rend të parë së bashku me të gjitha mirësitë e pafund që e shoqërojnë atë, Allahu me zemërgjerësinë e pafund të Tij e sheh si të përshtatshme që t'i shpërblej ata thjeshtë nga mirësia dhe dashamirësia e tij e pakrahasueshme.

SHPËRBLIMET PËR ATA TË CILËT I FRIKËSOHEN ALLAHUT

Atyre u jepen lajme të gëzueshme derisa janë në Tokë

Sa për ata të cilët jetojnë jetët e tyre në Tokë pa qenë të vetëdijën që frymëzon frikën ndaj Allahut, do të shqyrtojmë më poshtë, në dritën e Kuranit, frikët e pashpjegueshme që ata përjetojnë dhe ashpërsinë e tmerrshme të madhësisë së Allahut. Ata, në anën tjetër, të cilët i frikësohen Allahut dhe janë të kujdesshëm, në kundërshtim të plotë me këtë, do të arrijnë në Ahiret siguri të plotë prej çdo lloj frike dhe do të jetojnë jetët e tyre nën mbrojtjen dhe mirësinë e Allahut. Ata besimtarë të sinqertë të cilët gjatë gjithë jetës së tyre kanë pasur një parandjenjë të thellë për mundësinë e ndëshkimit në Zjarr kur të arrijë Dita e Gjykimit, do të mbahen larg nga çdo lloj frike dhe do të jenë absolutisht të sigurt. Ndërsa Allahu jap këto lajme të gëzuara në Kuran, në Ditën e Fundit Ai do t'ju drejtohet robërve të Tij dhe do t'ju kumtojë atyre edhe shumë më tepër lajme të gëzueshme:

(Allahu do t'u thotë): “O robërit e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni. Ju që keni besuar shpalljet Tona dhe keni qenë myslimanë, hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja, ku do t'ju shërbehet me pjata dhe gota prej ari. Aty do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë. Ja, ky është Xheneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë. Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani.” (Sure Zuhruf: 68-73)

Në ajetet tjera Kuranore, Allahu do të kumtojë këto lajme të gëzueshme me ndërmjetësimin e engjëjve të Tij, që padyshim do të jenë një gëzim i jashtëzakonshëm për besimtarët të cilët shpresojnë Kopshtin me aq forcë:

Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzohuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkoni, dhuratë e pasur prej një Zoti Falës dhe Mëshirëplotë.” (Sure Fussilet: 30-32)

Kurani thekson se këto lajme të gëzueshme, të cilat zgjasin përjetësisht dhe janë përplot mirësi, do të arrihen prej atyre të cilët besuan sinqerisht gjatë jetës së tyre në Tokë.

Një jetë e bukur

Jetët e atyre të cilët nuk besojnë në Allahun, të cilët nuk i frikësohen Atij dhe të cilët nuk sillen në mënyrë të kujdesshme, në pajtim me ndëshkimin që e meritojnë, do të privohen nga begatitë dhe mirësitë e rezervuara për besimtarët:

Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë. (Sure A’raf: 96)

Mirëpo, atyre të cilët besojnë në Allahun që posedojnë vetëdije plot frikë-respekt dhe që kanë treguar karakter të mirë në sjelljen e tyre, do t’ju jepen lajmet e gëzuara në Jetën e Përtejme të Xhenetit dhe në këtë botë do të përfitojnë në mënyrën më të mirë të mundshme nga mirësia dhe begatitë e Allahut:

Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë. (Sure Nahl: 97)

Ngjashëm me mënyrën në të cilën ndëshkimi i pafund i jobesimtarëve fillon derisa janë ende në Tokë, për besimtarët e sinqertë dhe të kujdesshëm,

mirësia e premtuar e pafund do të fillojë të manifestohet gjithashtu. Si rezultat i begatisë dhe bukurisë qenia midis veçorive më të dalluara të Kopshtit, Allahu do t'ju dhurojë të dashurve të Tij, robërve që ndiejnë frikë-respekt një shijim të këtyre mirësive derisa ata ende janë duke jetuar në Tokë në mënyrë që të shtoj mallin dhe dëshirën e tyre për Kopshtin/Xhenetin.

Gjithashtu, Allahu do të mbrojë besimtarët nga çdo lloj ankthi dhe shqetësimi gjatë jetës së tyre për shkak të besnikërisë së tyre ndaj urdhrave dhe ndalesave të Tij, për arsye të jetesës së tyre në pajtim me fenë e Tij dhe, ajo që është më rëndësishmja, për arsye të mbështetjes së tyre të vazhdueshme në Të, durimin e tyre dhe mallin e tyre për Ahiretin. Në vend të shqetësimit, Allahu bën që në zemrat e tyre të zbres një ndjenjë e qetësisë dhe sigurisë. Në çdo akt adhurimi apo mirësjelljeje, të madh apo të vogël, ata janë të vetëdijshëm se Allahu po i vështron ata dhe se engjëjt regjistruan e regjistrojnë atë në librin e veprave të tyre, andaj, ata përjetojnë një qetësi që shkaktohet nga dijenia se në Ahiret ata do të shpërblehen për gjithë këtë.

Mirëpo, në anën tjetër, ekziston një çështje tjetër që nuk duhet harruar: bota është vend i sprovës. Është më se e sigurt se një besimtar i sinqertë do të mund të përballet me vështirësi dhe kriza. Mirëpo, pa marr parasysh rrethanat, për një besimtar i cili i frikësohet Allahut këto vështirësi rezultojnë të jenë mëshirë dhe shpërblim. Shembull i mirë për këtë është Profeti Ibrahim (Abraham) (as) i cili, duke qenë i akuzuar për gënjim edhe përkundër faktit se ishte gati të hidhej në zjarr nga njerëzit e tij, ai nuk bëri as edhe kompromisin më të vogël në lidhje me fenë e tij apo luhatje lidhur me bindjen dhe besimin e tij në Allahun.

Pa dyshim se të digjesh për së gjalli është një ndëshkim i tmerrshëm por në rastin e Profetit Ibrahim (as) Allahu ka urdhëruar zjarrin të jetë “freski dhe qetësi” për të dhe nuk i shkaktoj asnjë dhimbje apo vuajtje. Pikëllimi, dëmtimi dhe fatkeqësia janë një ndëshkim apo paralajmërim të cilat ndodhin vetëm si rezultat i sjelljes së padrejtë apo i sjelljes së keqe të një personi: **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vet...”** (Sure Shura: 30)

Përndryshe, për një besimtar të sinqertë i cili i frikësohet Allahut aq sa ka mundësi dhe i cili është vazhdimisht i ndërgjegjshëm për aprovimin e Allahut për sjelljen e tij, as që bëhet fjalë për ndëshkim.

Të gjitha vështirësitë të cilat besimtarët e sinqertë i përjetojnë në këtë botë përballohen si sprova të cilat vetëm se shtojnë respektin dhe vetëdijen e përzier me ndjenjën e frikës që ata kanë ndaj Allahut, si edhe duke e rritur më tej dëshirën e tyre për Xhenetin (Kopshtin). Një besimtar i sinqertë është i vetëdijshëm se këto vështirësi janë krijuar për të si sprovë dhe përvojë mësimi dhe si mundësi për të shfaqur sjellje të mirë, duke shfaqur durim dhe për sa kohë që mbështetet në Allahun, si një mundësi për shpërblim në Ahiret. Kurani përmend cilësinë e veçantë e aftësisë për t'i konsideruar të gjitha ndodhitë si mundësi, në lidhje me ata të cilët besojnë sinqerisht dhe të cilët kanë ndjenjën e frikës së Allahut:

Ndërsa atyre që e kanë frikë Allahun, do t'u thuhet: “Çfarë ju ka shpallur Zoti juaj?” - Ata do të thonë: “Mirësi!” Ata që bëjnë vepra të mira në këtë botë, do të kenë mirësi; në botën tjetër do të kenë edhe më të mira. Sa e mrekullueshme do të jetë shtëpia e atyre që i frikësohen Allahut! (Sure Nahl: 30)

Vdekja e një besimtari të sinqertë i cili ka jetuar në Tokë me ndershmëri do të jetë e mirë dhe e lehtë, jeta e përtejme e tij do të fillojë me mirëseardhjen e engjëjve dhe vazhdimi i saj do të jetë rehatia dhe lehtësia që e pret secilin besimtar të sinqertë.

Dhënie e lehtë e llogarisë

Besimtarët e sinqertë do të garojnë në bërjen e veprave të mira gjatë gjithë jetës së tyre për shkak të frikës së tyre për përballjen me dhënie të frikshme të llogarisë në Ahiret. Ata do t'i respektojnë me përpikëri kufijtë e Allahut. Kurani përshkruan këtë frikë të besimtarëve të sinqertë në këtë mënyrë:

Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), tmerri i së cilës përhapet gjithkund. Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të

zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: “Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.” (Sure Insan: 7-10)

Në Ahiret Allahu do të ndriçojë fytyrat e atyre të cilët i frikësohen Atij dhe do të lehtësohet dhënia e llogarisë së tyre tek Ai. Libri i veprave të tyre do t’u jepet atyre në dorën e tyre të djathtë dhe do të lehtësohet dhënia e llogarisë të cilës ata i janë frikësuar:

Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. (Sure Inshikak: 7-9)

Kur të mbarojë dhënia e llogarisë, besimtarët e sinqertë do të ndiejnë lumturi për shkak të shpëtimit nga ndëshkimi i Xhehenemit. Siç tregohet në ajetin e mësipërm, ata do të kthehen te të dashurit e tyre të gëzuar.

Një jetë e përjetshme në Kopsht (Xhenet)

Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej Allahut. Dhe ajo që është tek Allahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë. (Sure Ali Imran: 198)

Xheneti që u është premtuar besimtarëve është i tillë që, nëpër të rrjedhin lumenj; frutat dhe freskia e tij janë të përhershme. Ky është fundi i besimtarëve, kurse fundi i jobesimtarëve është zjarri. (Sure Rra’d: 35)

Besimtarët të cilët i frikësohen një takimi me ndëshkimin e përjetshëm të Xhehenemit dhe të cilët janë të ndërgjegjshëm që të mos ngrënë krye kundër Allahut, do të fitojnë shpërblimin e atyre të cilët frikësohen dhe veprojnë me kujdes ashtu siç ka premtuar Allahu dhe ata do të dërgohen të hyjnë në banesën e tyre të përjetshme:

Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në

Xhenet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: “Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!” Ata do të thonë: “Lavdi Allahut, që përmbushi premtimin e Vet e na dha në trashëgim Xhenetin, ku të vendosemi si të duam!” Sa i mrekullueshëm është shpërblimi i atyre që kanë punuar drejt! (Sure Zumer: 73-74)

Për besimtarët e sinqertë të cilët hyjnë në Xhenet, befasia më e gëzueshme dhe burimi më i madh i lumturisë dhe ngazëllimit mbi të gjitha, do të jetë përshëndetja e Allahut:

“Paqe!” do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë. (Sure Ja'sin: 58)

Allahu do t'ju drejtohet besimtarëve të sinqertë në Xhenet si vijon:

“O robërit e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni.” (Sure Zuhruf: 68)

Allahu, i Cili krijoi njerëzimin, është më i vetëdijshëm se ne për atë se çka do të na gëzonte ne më shumë si shpërblim që kemi besuar në Të dhe mu këto gjëra janë ato që do t'i presin besimtarët në Xhenet. Andaj, mirësitë e pafund të Xhenetit dhe mrekullitë që mban në vete tejkalojnë jashtë çdo mase diapazonin e imagjinatës së njeriut. Mirësi të tilla të pafund do t'ju ofrohen besimtarëve që syri i njeriut kurrë nuk i ka parë ndonjëherë dhe veshi i njeriut kurrë nuk i ka dëgjuar; për gjithë përjetësinë gjithçka me çka takohen ata do të plotësojë çdo dëshirë të tyre:

... Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan; kjo është dhurata e madhe. (Sure Shura: 22)

Kurani përshkruan çdo aspekt të jetës së amshueshme për besimtarët në Xhenet, si vendbanimet e tyre, veshjen e tyre, bashkëshortet e tyre, bukurinë e mjedisit që i rrethon, ushqimet dhe kënaqësi tjera të ndryshme që i presin ata.

Në një ajet Kuranor krahasohen jetët e përjetshme që i jetojnë ata të cilët i frikësohen Allahut dhe fundi i llahtarshëm me të cilin do të përballen ata të cilët nuk i frikësohen Allahut:

Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj

Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehenemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?! (Sure Muhammed: 15)

Nuk ka dyshim se dikush që është i ndërgjegjshëm dhe i vetëdijshëm ka nevojë vetëm të reflektoj për këtë skenar për një moment në mënyrë që si shpresa ashtu edhe frika ndaj Allahut të bëhen më të fuqishme.

Shpërblimi më i madh: Kënaqësia e përjetshme e Allahut me ta

Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore. (Sure Teube: 72)

Kënaqësia më e madhe shpirtërore e përjetuar nga besimtarët kur hyjnë në Xhenet është realiteti që prej atij momenti e tutje Allahu është i kënaqur me ta, se i don Ata, se Ai nuk do t'i ndëshkojë kurrë ata, dhe se ata do të jenë shokët e Tij përjetësisht. Fitimi i kënaqësisë së Allahut do të jetë burimi i një gëzimi dhe lumturie pafundësisht më të lartë se çfarëdo krahasimi i dynjasë. Kënaqësia e Allahut është ajo që ju sjellë ëmbëlsinë përfundimtare mirësive të Xhenetit. Edhe pse shpërblimet e Xhenetit janë vetvetiu të mrekullueshme, ajo që është edhe më e këndshme është gëzimi i të qenit i pranuar nga Zoti i të gjitha Botrave, të meritosh fitimin e mirësisë së Tij. Kurani thotë:

O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim! (Sure Fexhr: 27-30)

ARSYET E DËSHTIMIT PËR T'JU FRIKËSUAR ALLAHUT

*Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?”
Ata do të thonë “Allahu”. E ti (o Muhamed) thuaj:
“Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” (Sure Junus: 31)*

Sic shpallet haptazi nga Allahu në ajetet e Tij, kur pyeten për këtë ata të cilët posedojnë vetëm besim sipërfaqësor, ata do të pranojnë besimin e tyre në Allahun, por vetëdija që frymëzon ndjenjën e frikës ndaj Tij do të jetë e mangët. Dëshmia më e qartë e gjendjes së tyre është se as në të folurit e tyre as në sjelljen e tyre ata nuk shfaqin as edhe shenjën më të vogël të frikës apo kujdesit ndaj Allahut. Ekzistojnë arsye të mirënjohura që përbëjnë themelin e kësaj.

Mungesa e vlerësimit të drejtë të Allahut

Përgjithësisht në mesin e popullatës është i përhapur një kuptim i fesë i mbështetur në thashetheme. Shumica e njerëzve nuk janë të njoftuar me përshkrimet që Allahu ia bën Vetes së Tij dhe me atributet e Tij ashtu siç shfaqen ato në burimin origjinal të fesë, domethënë në Kuran. Mirëpo Allahu na ka prezantuar Vetën e Tij në Kuran në mënyrën më të qartë dhe më të mirëfilltë të mundshme. Dituria e shumicës së njerëzve lidhur me Allahun përbëhet nga ajo që ata kanë dëgjuar nga familjet e tyre përkatëse, të afërmit

dhe aty apo këtu. Si rezultat i kësaj, mënyra e të kuptuarit të njerëzve lidhur me Allahun ndryshon në masë të madhe.

Ajo që është interesante lidhur me këtë është se një numri të madh të njerëzve nuk iu ka shkuar kurrë në mendje se gjërat që kanë dëgjuar apo ua kanë mësuar në mjediset ku ata jetojnë mund të jenë jo të mangëta apo madje edhe plotësisht të pasakta. Edhe po t'ju shkonte në mendje, do të ishte gati e pamundshme që ata të largohen nga mënyra e tyre e jetës për të bërë hulumtimin që do të kërkohej për të konstatuar të vërtetën. Ky është një gabim serioz i cili do të mund të rezultonte me shkuarjen në Zjarr si pasojë e mosnjohjes së Allahut si duhet apo për mosnjohjen e duhur të shumëtributeve të mrekullueshme të Tij.

Ky soj i njerëzve mendojnë se Allahu kur flasim në përgjithësi në lidhje me atributet e Tij të Falësit (El Gafar), Ndihmuesit (En Nasr), Furnizuesit (Er Rezak), të Ndjeshmit (El Latif), Shpëtuesit (El Hafiz), të Gjithëmëshirshmit (Er Rahim) dhe Mbrojtësit (El Muhajmin). Kufizimi i përqendrimit të tyre ndajtributeve si këto rezulton thjeshtë me një ndjenjë të çekuilibruar të rehatisë dhe vetëkënaqësisë, pasi që Allahu ka edhetribute tjera si Hakmarrësi “El Muntekim”, Ndëshkuesi (El Muazib) dhe Nënshtruesi (El Kahar). Mirëpo, njerëzit e përmendur më lartë nuk mund të dinë se ç’domethënie kanë në të vërtetë këtotribute të Allahut. Ata nuk mund të mendojnë për Zotin tonë në këtë mënyrë. Ata nuk e kuptojnë se këtotribute do të sjelljen për të dëshmuar për veprat e tyre, sjelljet e tyre dhe bisedimet e tyre.

Edhe pse ata mund të jenë të vetëdijshëm për disa prejtributeve të Allahut me emër, ata mbeten të pavetëdijshëm për rëndësinë e tyre të plotë dhe mënyrën në të cilën ata do të dëmtojnë jetët e tyre të përjetshme. Ata ose kanë një pikëpamje të njëanshme për atributet e shumta të Allahut, ose mendojnë se ato assesi nuk vlejnë për ta.

Për shembull, nëse atyre u është bërë ndonjë padrejtësi, ata besojnë se në Ahiret Allahu, me drejtësinë e Tij të pafund do të kërkojë ndëshkim për këtë padrejtësi. Mirëpo, ata dështojnë të kuptojnë se edhe ata do të ballafaqohen me

ndëshkimin e Allahut nëse nuk besojnë në Kuran dhe nuk veprojnë në pajtim me të ashtu siç janë të obliguar. Njerëzimi u krijua për të adhuruar Allahun, por nëse ata e refuzojnë qëllimin e krijimit të tyre, ata padyshim se do të ballafaqohen me pasojat e këtij mosbesimi. Për një gjynah të tillë të tmerrshëm kërkohet ndëshkimi më i rëndë i mundshëm, prandaj edhe ekziston Xhehenemi. Xhehenemi, duke qenë vendi më i tmerrshëm i krijuar ndonjëherë është arena e ndëshkimeve ashpërsia e të cilave tejkalon jashtë çdo mase aftësitë e imagjinatës njerëzore. Ai përfshin dhe tejkalon për shumë herë vuajtjet më të mëdha të imagjinueshme në Tokë.

Këta njerëz që ne përshkruajmë nuk posedojnë vetëdije dhe ndjenjën e frikës ndaj Allahut dhe sillen me mospërfillje, ata janë të pavëmendshëm ndaj vet ndërgjegjeve të tyre dhe u mungon plotësisht aftësia e të kuptuarit. Ata nuk posedojnë kuptim të drejtë të forcës së Allahut dhe fuqisë së Tij, madhësisë dhe pafundësisë së Tij, lartësisë dhe madhërisë së Tij. Prandaj, ata dështojnë të përjetojnë atë frikë-respekt të brendshëm dhe drithërimën e thellë që i përshtatet mundësisë së ekspozimit ndaj zemërimit të Tij. Si rezultat i kësaj, ata nuk përpiqen të fitojnë kënaqësinë e Allahut apo të zbatojnë urdhrat e Tij aq sa munden ata. Ata nuk veprojnë në përputhje me ndalesat e Tij, duke parapëlqyer të jetojnë jetë të shkujdesura. Ata dështojnë të shfaqin mirënjohjen dhe vlerësimin e duhur për të mirat që Allahu ua ka dhuruar, prandaj mosmirënjohja shndërrohet në një veçori të përhershme të qenieve të tyre. Megjithatë në fund, çmimi për të jetuarit e një jete të shkujdesur në Tokë do të paguhet me një jetë të përjetshme frike dhe vuajtje.

Besimet e gabuara të jobesimtarëve për Ahiretin

Sikurse nuk janë në gjendje që ta njohin Allahun ashtu si e meriton Ai, shumë njerëz të padijshëm posedojnë po ashtu dijeni të mangët dhe shumë besime të rrejshme në lidhje me Xhenetin dhe Zjarrin. Këta njerëz kalojnë jetët e tyre në Tokë ashtu si ju do zemra, ngrënë krye kundër Allahut dhe mandej, pandehin se do të falen pasi të kalojnë një kohë të shkurt në Xhehenem.

Mirëpo, fundi që i pret ata është shumë më i dhimbshëm se që pandehin ata, për arsye se Xhehenemi është një banesë e ndëshkimit që mund të zgjatë përjetësisht për ata jobesimtarë të skajshëm të cilët nuk iu kushtojnë vëmendje paralajmërimeve të Allahut. Allahu thekson se Xhehenemi është krijuar për jobesimtarët dhe për ata njerëz të cilët këmbëngulin në mosbesimin e tyre. Kurani e bën të qartë se nuk ka kthim për ta:

Me të vërtetë, Xhehenemi do të bëhet pusi, vendbanim i caktuar për keqbërësit, që aty të mbeten përgjithmonë. (Sure Nebe': 21-23)

Dhimbja dhe vuajtjet e Xhehenemit tejkalojnë imagjinatën. Xhehenemi është një mjedis i frikshëm ku vetia e Allahut e Nënshtruesit (El-Kahar) bëhet e qartë me tërë aspërsinë e saj dhe ku ndëshkimet që shkaktohen tejkalojnë çdo gjë të imagjinueshme në Tokë. Për një individ i cili mezi është në gjendje të përballoj dhimbjen e një pike të ujit të vluar, apo temperaturat e ulëta apo madje edhe urinë më të vogël, të pohojnë se ata mund të durojnë forma të tilla të ndëshkimit pa ndonjë vështirësi të madhe është tregues i qartë i mungesës së plotë të vetëdijes dhe të arsytimit të tyre. Siç kemi thënë që nga fillimi, cilido që mendon se ndëshkimi i Allahut është një gjë që duhet të merret në një mënyrë kaq mospërfillëse, është dikush që nuk e ka fare idenë për të vërtetën e fuqisë së Allahut.

Të mashtruarit me kohën e përcaktuar për ta në Tokë

Në mënyrë që njerëzit të sprovohen siç duhet, Allahu na ka dhuruar të gjithëve një periudhë të caktuar kohe në këtë botë kalimtare. Ai na dërgon paralajmërime dhe na dhuron çdo mundësi për tu penduar dhe për të përmirësuar gabimet që mund t'i kemi bërë. Mirëpo, për njerëzit të cilët nuk jetojnë në përputhje me fenë, pikërisht kjo bujari është pjesë e asaj që qëndron prapa paaftësisë së tyre për t'iu frikësuar Allahut ashtu siç duhet. Për t'iu shmangur pasojave të veprimeve të tyre, njerëzit në përgjithësi janë jashtëzakonisht të kujdesshëm kur bëhet fjalë për sjelljen e cila sjell një përgjigje të menjëhershme. Le të shikojmë shembullin vijues.

Le të supozojmë se një person punon për një kompani dhe ka një rrogë të mirë dhe i janë parashtruar një numër i rëndësishëm i qëllimeve që duhet përmbushur, duke e ditur se dështimi për t'i arritur këto qëllime ka mundësi të rezultojë me ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës me këtë kompani. Nuk kërkohet përdorim i tepruar i imagjinatës për të marr me mend se çfarë përpjekje të mirëfillta dhe çfarë përkushtimi do të nevojitet për përmbushjen e kësaj detyre. Vetëm mendimi për humbjen që do të përjetonte ai me rastin e humbjes së vendit të tij të punës do të garantonte që çfarëdo qasje ndaj saj më e vogël të mos merrej fare parasysh. Ai do të bënte gjithçka, madje edhe me çmimin e sakrifikimit të rehatisë së tij, gjumit të tij dhe madje braktisjes së obligimeve tjera për të përmbushur synimet e tij dhe për t'iu shmangur shqetësimit që do të mund të rezultonte nga dështimi. E gjithë kjo është një gjë e mirë por parashtrohet pyetja nëse njerëzit e tillë ndiejnë të njëjtën shkallë nxitimi në raport me të vërtetën shumë më të madhe se duhet t'i japin llogari Allahut? E vërteta është se shumica e njerëzve nuk e ndiejnë ngase ata nuk e shohin vdekjen dhe Ahiretin si të vërteta të pashmangshme, sipas tyre jeta që e jetojnë ata është shumë më reale.

Mirëpo në një ajet Kuranor kohës së përcaktuar në Tokë që ju është dhënë njerëzve i referohet si vijon:

Sikur Allahu t'i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë, nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë, por Ai i shtyn ata deri në afatin e caktuar dhe, kur t'u vijë afati i tyre, ata do ta dinë se Allahu i mbikëqyr mirë robërit e Vet. (Sure Fatir: 45)

Këta njerëz supozojnë se kur ata bëjnë diçka me të cilën Allahu nuk është i kënaqur ata do të ndëshkohen në atë çast me “reshje squfuri,” por kur del se nuk është kështu ata e kuptojnë këtë si leje për të vazhduar me teprimet e tyre. Kjo formë e palogjikshme e të menduarit mund të shihet te pjesëtarët e bashkësive mosbesimtare të cilët kanë jetuar në çdo kohë gjatë historisë dhe mënyra e të gjykuarit e të cilëve përshkruhet nga Allahu në Kuran në këtë mënyrë:

... dhe thonë me vete: “Pse nuk na dënon Allahu për këtë që po flasim?”

Xhehenemi është një dënim i mjaftueshëm për ata. Në flakët e tij do të digjen. Eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai! (Sure Muxhadile: 8)

Kjo pikëpamje e shtrembëruar mbrohet nga shumica e njerëzve të cilët nuk besojnë dhe nga njerëzit besimi i të cilëve është vetëm sipërfaqësor. Këta njerëz të cilët besojnë se nuk do të ndëshkohen për veprimet e tyre dhe të cilët për këtë arsye mendojnë se janë tepër të mençur, janë në fakt duke u tërhequr gradualisht drejt ndëshkimit të tyre pa e kuptuar këtë:

Ndërsa ata që i mohojnë shpalljet Tona, dalëngadalë Ne do t'i shpiem drejt shkatërrimit, pa e kuptuar. (Sure A'raf: 182)

Ngjashëm me ndëshkimet e hapta dhe të qarta të cilat Allahu i ka përmendur në Kuran, ndëshkimet e paperceptueshme dhe të fshehta mund ta zënë një person në befasi në çdo kohë, madje derisa ende jeton në Tokë. Një shembull i tillë është rasti kur dikush i cili e ka zakon të shfaq qëndrime apo sjellje morale të cilat janë fyese për Allahun, goditet befas nga një sëmundje shkatërruese. Nuk është nevoja të thuhet se këto të këqija nuk kufizohen vetëm në shqisat fizike; frika me të cilën Allahu do ta kaptoj zemrën apo vetëm shqetësimi i mprehtë, do të mjaftojnë për ta bërë ekzistencën e një individi tepër të mundimshme. Prandaj Allahu ka tërhequr vëmendjen në Kuran ndaj frikës që është një lloj ndëshkimi:

All-llahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut. Atëherë All-llahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun (ua ngjeshi) e urisë dhe të frikës. (Sure Nahl: 112)

Derisa sillet në një mënyrë me të cilën Allahu nuk është i kënaqur, asnjë njeri nuk mund të jetë kurrë i sigurt se fatkeqësia nuk i qëndron pezull mbi kokë, e gatshme ta godas në çdo moment. Nuk ka mbrojtje ndaj asnjërit prej ndëshkimeve të Allahut. Allahu na ka bërë me dije për këtë realitet në Kuran:

A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve se nuk do t'iu vijë dënimi Ynë natën, ndërkohë që flenë?! A janë të sigurt ata se nuk do t'iu vijë

dënimi Ynë ditën, ndërkohë që argëtohen?! A janë të sigurt ata nga të papriturat e Allahut? Vetëm ata që janë të humbur nuk u frikësohen të papriturave të Allahut. (Sure A'raf: 97-99)

I njëjti paralajmërim përsëritet në një ajet tjetër:

Vallë, a jeni të sigurt, që Ai nuk do t'ju fundosë në tokë ose, që nuk do të dërgojë mbi ju stuhi me rërë, pa pasur mundësi që ju të gjeni dikë, që t'ju mbrojë? Apo jeni të sigurt, që Ai nuk do t'ju kthejë ju përsëri (në det) e, që nuk do t'ju dërgojë furtunë e t'ju fundosë për shkak të mosbesimit tuaj, pa pasur mundësi që të gjeni dikë, që t'ju mbrojë nga Ne? (Sure Isra': 68-69)

Nuk duhet harruar se njerëzimi është në gjendje vartësie dhe se ne jemi plotësisht të varur nga Allahu për çdo gjë. Shqetësimet e sprovave dhe vështirësive mund të ballafaqohen vetëm duke u mbështetur në Allahun dhe duke marr forcë prej Tij. Megjithatë, ata të cilët nuk e pranojnë realitetin e aftësisë së tyre të kufizuar dhe të cilët nuk i frikësohen Allahut lihen që të përballen vetëm me ndëshkimet dhe fatkeqësitë e tyre, si me ato që shihen haptazi ashtu edhe me ato të fshehtat. Duke e pasur parasysh se natyra e njeriut nuk posedon aftësinë për t'iu bërë ballë këtyre të këqijave, e vetmja rrugë e sigurt dhe e suksesshme është që ta kenë frikën e Allahut ashtu si dinë më së miri dhe ta jetojnë një jetë të bazuar në mënyrë të ndërgjegjshme në vetëdijen plot frikë-respekt që frymëzojnë këto të vërteta.

Supozimi se vetëm më të pabindurit do t'i nënshtrohen ndëshkimit

Përkundër faktit se shumica e njerëzve e dinë se pas vdekjes së tyre, Allahu do t'i thërras ata për të dhënë llogari për mënyrën se si kanë jetuar jetët e tyre, dhe se pas kësaj dhënie të llogarisë ata do të dërgohen ose në Xhenet ose në Zjarr, ata nuk përgatiten për jetën e tyre në Ahiret. Edhe pse këta njerëz

pohojnë besimin e tyre në ekzistencën e Ahiretit, mënyra se si e jetojnë jetën e tyre mezi dallon nga ajo e jobesimtarëve të haptë. Veç kësaj, ata nuk shfaqin as edhe shenjën më të vogël të turpërimit për këtë.

Mënyra e të jetuarit e të dy grupeve është, në të vërtetë, identike për nga pamja, qëndrimet, sjellja, synimet dhe ambiciet. I vetmi ndryshim në mes tyre është se njëri pohon të jetë Musliman, ndërsa tjetri nuk pohon një gjë të tillë. Përkundër gatishmërisë së grupit të parë që të pohojë besimin e tyre në Kuran, dështimi i tyre për të vepruar në përputhje me gjykimet e librit ata pohojnë të besojnë në atë që nuk shkakton tek ata çfarëdo ndjenje shqetësimi apo bezdie.

Arsyeja për gjendjen e tyre të mospërfilljes së qartë deri te natyra haptas kundërtëhënëse e gjendjes së tyre është pohimi i tyre i mëtejshëm se zemrat e tyre janë të pastra dhe se ata askujt nuk i shkaktojnë asnjë dëm.

Qëndrimi i tyre mbështetet në besimin kategorik se ata kurrë nuk do të dërgohen në Zjarr, me fjalë tjera ata e konsiderojnë vetveten si kandidatë të sigurt për pranim në Xhenet. Ajo që është po ashtu veçanërisht interesante janë kriteret që ata kanë sajuar për të përcaktuar tipin e personit i cili do të hyj në Zjarr dhe mendjemadhësia gjegjëse me të cilën ata shpallin çdokënd tjetër si të përshtatshëm për Xhenet.

Sipas tyre, njerëzit që e meritojnë Zjarrin janë kriminelët dhe shkelësit e ligjit të cilët njeriu përgjithësisht i sheh në televizion apo në gazeta si vrasësit, hajnat, terroristët dhe të devijuariat e ndryshëm të cilët janë të vendosur që t'u shkaktojnë dëm të tjerëve. Ata të cilët janë lënë jashtë kësaj liste, “personi i rëndomtë,” të cilët megjithatë përbëjnë pjesën më të madhe të njerëzimit, pandehin se të gjitha gjynahet e tyre do të falen menjëherë.

Natyrë e kriterëve që ata vet kanë zgjedhur është ajo e cila ka shkaktuar supozimin se ata janë prej banorëve të Xhenetit, duke pasur parasysh se ata nuk kanë kryer ndonjë vrasje apo nuk kanë vjedhur asgjë dhe se ata nuk janë terroristë. Pra pavarësisht nga pohimet e tyre se janë Myslimanë, as gatishmëria e tyre për të kryer të gjitha format e mëkatit, as mosgatishmëria e tyre për të adhuruar, as mosgatishmëria e tyre për të vepruar në përputhje me

Kuranin dhe për të jetuar jetën e tyre në siguri brenda kufijve të përcaktuar nga Allahu, nuk nxitë tek ata asnjë ndjenjë frike dhe nervozizmi. Arsyeya e thjeshtë për këtë është supozimi i tyre i gabuar se asnjëra prej këtyre veprimeve apo lëshimeve nuk përbën arsye të mjaftueshme për tu dërguar në Zjarr.

Mirëpo, ky është një gabim i tmerrshëm, i cili mund t'i tërheq ata për në humnerat e Zjarrit. Këta njerëz në emër të Islamit thirren në vlera dhe prioritete, të cilat janë shumë të ndryshme prej atyre që përmban Kurani. Me fjalë tjera, çështjet mbi të cilat Allahu vendos rëndësinë më të madhe përfundojnë, sipas gjykimit mendjehhtë të tyre, duke u konsideruar si çështje të papërfillshme. Kështu, perspektivat e tyre fetare të vet-shpikura ju ofrojnë atyre një mënyrë të jetës e cila është në kundërshtim të plotë me një frikë të sigurtë ndaj Allahut. Në ajetin vijues Kuranor Allahu tërheq vëmendjen ndaj logjikës së shtrembëruar të këtyre njerëzve:

Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë “Allahu”. E ti (o Muhamed) thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” (Sure Junus: 31)

Këta njerëz nuk mund t'iu përmbahen urdhrave dhe ndalesave të fesë së vërtetë për shkak të përkushtimit të vendosur të tyre ndaj interpretimit të tyre të gjërave. Prandaj, ata vazhdojnë të jetojnë jetët e tyre nën ndjenjën e një sigurie të rrejshme të shkaktuar nga keqkuptimi fatal se ata janë të përcaktuar për Xhenet; ata janë vetëm duke e mashtruar vetveten. Mirëpo, pa marr parasysh se deri në çmasë ata e mashtrojnë vetveten ndërgjegjja e tyre do t'i përkujtojë ata gjithnjë për realitetin e vërtetë. Kur përballen me realitetet e Kuranit, atyre ju duket e pamundshme të pranojnë se i kanë shpenzuar kot jetët e tyre në gjynahe dhe gabime të rënda, ata refuzojnë plotësisht të dëgjojnë cilindo që përpiqet t'ua qartësoj atyre këtë gjendje. Prandaj, për të mos menduar për këtë, ata me vetëdije largojnë vëmendjen e tyre duke u përqendruar në çështje tjera. Me fjalë tjera, kur të ndodhë diçka apo kur në mendjet e tyre depërton një

mendim që mund t'ju shkaktoj frikë apo shqetësim, ata menjëherë largojnë vëmendjen e tyre tjetërkund, duke preferuar të mbeten në një gjendje të një sigurie joreale. Ata përpiqen të ndalojnë mendimet për Allahun, për kërcënimet e Tij dhe ndëshkimin e Tij, me fjalë tjera, ata ekzistojnë në një gjendje të mohimit të vazhdueshëm të realitetit të gjendjes së vështirë të tyre: pamundësisë për t'iu shmangur drejtësisë së pashmangshme të Allahut. Pa marr parasysh sa shumë përpiqen, vendosmëria e tyre e pamend për t'iu shmangur të vërtetës nuk do t'i shpëtojë ata nga përfundimi i frikshëm që i pret ata.

Ideja se “Allahu do të na falë gjithsesi”

Pas tyre, erdhi një brezni e cila e trashëgoi Librin (Teuratin), por duke marrë gjërat e pavlefshme të kësaj bote dhe duke thënë: “Do të na falet çdo gjë!” (Sure A'raf: 169)

Siç tregohet në këtë ajet, përkundër faktit se nuk kanë jetuar jetën siç janë urdhëruar prej Allahut, njerëzit pandehin se ata prapëseprapë do të falen. Pa dyshim, arsyeja kryesore për këtë supozim është paaftësia e tyre për të kuptuar drejtë vetitë e Allahut dhe drejtësinë e Tij për arsye të mbështetjes së tyre në një mënyrë të gjykimit që mbështetet pak ose aspak në Kuran. Edhe pse Allahu është falës dhe do t'i falë veprat e gabuara të robërve të Tij, parakushti për këtë falje është nënvizuar nga Allahu në Kuran si vijon:

Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë. Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë po pendohem”. As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm. (Sure Nisa: 17-18)

Mirëpo, ka të atillë të cilët pasi që pandërprerë kanë qenë të paralajmëruar si haptazi ashtu edhe fshehurazi, janë të vetëdijshtëm për të vërtetën dhe prapëseprapë mbeten larg frikës ndaj Allahut dhe këmbëngulin në pohimin e

tyre të shtrembëruar se Allahu do t'i falë ata prapëseprapë. Kjo formë e keqkuptimit është një shembull i qartë i aftësisë së Shejtanit për t'i çorientuar dhe mashtruar njerëzit. Ky është njëra prej joshjeve të shumta të tij, e cila shpie drejt kryerjes së vazhdueshme të të gjitha formave të veprave të gabuara dhe mashtrimeve. Veç kësaj, shpallja e Allahut se: **“Askush nuk është i sigurt nga ndëshkimi i Zotit të tij”** (Sure Me'arixh: 28), është provë e qartë se askujt nuk i garantohet falja në këtë mënyrë.

Konsiderimi i vetvetes si njerëz që e meritojnë

Xhenetin

Nuk ka asnjë dyshim se të kuptuarit e shtrembëruar të Kuranit do t'i hap udhë një pikëpamjeje të ngjashme të shtrembëruar për Ahiretin. Prandaj, shumica e njerëzve të padijshëm ndajnë besimin e përbashkët se ata e meritojnë Xhenetin. Shumica e këtyre njerëzve nuk posedojnë ndonjë koncept për marrjen në pyetje për veprat e tyre pas vdekjes. Sipas tyre, edhe po të ekzistonte një mundësi e tillë ata mendojnë se do të hasnin në një përfundim pozitiv, duke e mashtruar kështu vetveten me një ndjenjë të rrejshme sigurie.

Allahu ka dhënë një shembull në Kuran për një pronar të një kopshti i cili ishte mendjemadh dhe kishte besim në vetvete. Ai nuk i frikësohej Allahut dhe ishte tejet i prishur për shkak të pasurisë së tij. Prodhimet e shumta të kopshteve të tij si edhe bukuria e tyre shërbyen si bazë për krijimin e këtij vetëbesimi. Ndjenja e fuqisë që buroi nga ky vetëbesim e shtyri atë të besoj se pronat e tij ishin të pashkatërrueshme dhe të përhershme dhe ai përvetësoi një qëndrim të një paturpësie të plotë:

Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe, duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: “Unë nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopsht)”! (Sure Kehf: 35-36)

Pronari i kopshtit shërben si shembull për njerëzit sot të cilët në thelb kanë harruar Ahiretin dhe Ditën e Gjykimit dhe të cilët i kanë tejkualuar dhe nuk i kanë respektuar kufijtë e përcaktuar nga Allahu. Veç kësaj, të ballafaquar me mundësinë, ashtu siç e kuptojnë atë, e mosekzistencës së përjetshme apo ndoshta të moshyrjes në Zjarr dhe mospërballjes me ndëshkimin e tij, ata e mashtrojnë vetveten me idenë se ata në fund do të hyjnë në Xhenet. Sjellja e atyre njerëzve mentaliteti i cekët i të cilëve u jap leje që ta mohojnë Ditën e Gjykimit kur atyre iu shkon për shtati, dhe të cilët në të njëjtën mënyrë, arrijnë të përfytyrojnë vetveten si të denjë për Xhenetit, është një tregues i qartë se atyre u mungon vetëdija me ndjenjën e frikës së Allahut (lack fearful awareness).

Pohimi i tyre se e duan Allahun

Një arsye tjetër pse njerëzit nuk i frikësohen Allahut dhe nuk veprojnë në mënyrë të vëmendshme është pohimi i tyre se ata e duan Allahun. Mirëpo, dashuria e vërtetë ndaj Allahut kërkon respekt dhe largim të vetvetes nga ato gjëra që nuk i do më i dashuri, por ajo që është interesante është se kur e analizojmë mënyrën e jetës së këtyre njerëzve nuk mund të gjendet asnjëra prej këtyre dëshmimeve. Një person i cili e do sinqerisht Allahun do të jetë mbi të gjitha tejet i ndjeshëm ndaj kufijve të Allahut, do t'i dojë gjërat që Ai i do dhe do të jetë jashtëzakonisht i kujdesshëm për ato gjëra që Allahu nuk i do. Në çdo element të jetës së tij, ai do të përpiqet ta kënaq Atë duke demonstruar respektin e thellë të tij, besimin dhe bindjen e tij me përkushtim absolut. Mirëpo, dikush i cili deklaron se e do Allahun përkundër faktit se jeton një jetë, e cila tejkalon kufijtë e Allahut, nuk mund të jetë duke folur me sinqeritet. Kjo mungesë e sinqeritetit në mënyrë të pashmangshme do të tërheq hakmarrje dhe një ndëshkim të ashpër.

Ajo që ka rëndësi këtu është se një deklaram verbal i një dashurie të këtillë nuk është asgjë më shumë se një ushtrim për vetëmashtrim dhe një shfaqje e jashtme e vetëbesimit të tepruar. Qëndrime të tilla janë në kundërshtim të plotë me shpirtin dhe porosinë e Kuranit.

Frika e bazuar në mosdije

Allahu është i njoftuar mirë me gjendjet e njerëzve dhe me çdo shpresë, lutje dhe mendim që kalon nëpër mendjet e tyre. Duke qenë kështu, ajo që duhet bërë njeriu është t'i drejtohet Allahut me sinqeritet dhe të kërkoj miqësinë e Tij. Një frikë e brendshme e sinqertë lind një gatishmëri që do të sigurojë nënshtrim (bindje), do të inkurajojë një gjendje të moralit pozitiv dhe përparimit drejt fitimit të dashurisë së Allahut.

Mirëpo, frika e njerëzve të cilët nuk jetojnë në pajtim me fenë, ndryshon. Ndjenja e tyre e frikës është e përkohshme. Kur ata sprovohen me një situatë të vështirë, ata e përkujtojnë zemërimin e Allahut dhe iu frikësohen pasojave. Megjithatë, ata kthehen në gjendjen e tyre të mëparshme të mohimit posa Allahu t'i shpëtoj ata nga vështirësia e tyre. Lidhur me këtë çështje Kurani jap shembullin në vazhdim:

Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhi dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t'i vënë poshtë, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: “Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës”. E kur Allahu i shpëton ata, ata përnjëherë pa kurrfarë të drejte bëjnë turbullira në Tokë. O njerëz! Vërtet, padrejtësia që bëni për t'u kënaqur në jetën e kësaj bote, vetëm ju dëmton. Pastaj ju do të ktheheni te Ne dhe Ne do t'ju njoftojmë për atë që keni punuar. (Sure Junus: 22-23)

Siç shihet nga shembulli i lartpërmendur frika e njerëzve të tillë nuk do t'ju sjellë dobi atyre. Në kundërshtim të plotë me besimtarët, ata nuk do të mësojnë dhe të bëhen të vëmendshëm apo të mendojnë mbi kuptimin e ngjarjeve të tilla. Prandaj, Allahu na informon në Kuran se ata të cilët përjetojnë ndjenjën e frikë-respektit do të bëhen të vëmendshëm:

Asaj do t'ia vërë veshin ai që (i) frikësohet (Allahut), e do t'i shmanget vetëm më i keqi, (Sure A'la: 10-11)

Këtu ne shohim se njerëzit e pasinqertë që përmenden në ajetet e mësipërme janë nga ky grup i dytë i njerëzve. Kjo është për arsye se ata nuk posedojnë një ndjenjë të një frike të thellë të brendshme ndaj Allahut. Ndodhitë me të cilat ata përballen nuk do t'i udhëzojnë ata drejt rrugës së drejtë. Allahu na ka bërë me dije në Kuran për sjelljen e këtyre njerëzve në një numër të madh të ajeteve. Për shembull:

Thuaj: “E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini?”
Ata do të thonë: “Të Allahut!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk po ia vini veshin?” Thuaj: **“Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?”** Ata do të thonë: **“Allahu!”** E ti thuaju: **“Vallë, a nuk keni frikë ju?”** Thuaj: **“Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?”** Ata thonë: **“Allahu.”** E ti thuaju: **“Atëherë, përse magjepseni”?!**
Ja! Ne ua kemi zbuluar atyre të Vërtetën, por ata janë gënjeshtarë.
(Sure Muminun: 84-90)

ÇFARË VLERA MORALE POSEDON NJË PERSON I CILI NUK I FRIKËSOHET ALLAHUT

Cilësia e drejtësisë është e arritshme vetëm duke i frikësuar Allahut dhe duke iu përmbajtur plotësisht urdhrave të Tij. Që një person të posedoj dhe të ruaj një karakter të drejtë, nevojitet një dashuri e fortë ndaj Allahut e shoqëruar me një frikë të thellë ndaj Allahut. Sa i përket frikës së Allahut ashtu siç e meriton Ai, kjo është bërë e mundshme vetëm duke përkujtuar dhe duke menduar vazhdimisht për madhështinë, lavdinë dhe fisnikërinë e Allahut, pozitën e Tij të lartë, dijeninë dhe pushtetin e pafund dhe sovranitetin e Tij të pakufizuar dhe të pakushtëzuar mbi të gjithë robërit e Tij, si edhe duke pasur një besim të plotë në premtimet dhe kërcënimet e Allahut, Ditën e Gjykimit dhe fuqinë e sprovave të rënda të tij dhe ndëshkimin e frikshëm dhe të amshueshëm. Ky besim do të hap udhë për një frikë të përforcuar ndaj Allahut. Kjo frikë do të sigurojë po ashtu që qëndrimi i njeriut, sjellja, lëvizjet dhe bisedat e njeriut të jenë në pajtim dhe në harmoni me standardet morale me të cilat është i kënaqur Allahu. Një person i cili i frikësohet Allahut do të jetë në një gjendje të vazhdueshme të vigjilencës kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kufijve të Tij.

Sa u përket njerëzve të cilët nuk i frikësohen Allahut, ata janë në gjendje të shfaqin çdo lloj qëndrimi, pavarësisht prej pakënaqësisë së Allahut. Dikush që ka harruar se do t'i jap llogari Allahut nuk ka nevojë apo arsye të jetë i sinqertë, tu shërbej të tjerëve, të jetë i drejtë dhe i ndershëm, shkurt, të shfaq sjellje të

mirë morale. Ata janë të motivuar vetëm nga ambicia individuale dhe përfitimi personal. Ata e konsiderojnë si të pavend t'u bëjnë mirë të tjerëve.

Nuk ka asgjë që këta njerëz nuk do të bënin për të përfituar vet. Për shkak të paaftësisë së tyre për të njohur fuqinë e Allahut, mundësia e ndëshkimit të Allahut nuk shërben si një nxitje për të përmirësuar mënyrën e tyre të jetës. Pasi që ata nuk posedojnë frikën ndaj Allahut apo ndëshkimit të Tij, ata nuk iu përmbahen asnjë kufizimi, ata shpërfillin ndalesat e Allahut, duke shfaqur një sjellje shtypëse ndaj njerëzve dhe duke ia tepruar në çdo gjë negative. Pasi që ata nuk mendojnë për fuqinë Allahut dhe aftësinë e Tij për t'u hakmarrë, ata shkelin kufijtë e Allahut pa menduar fare.

Këto janë arsyt pse ata njerëz të cilët nuk i frikësohen Allahut nuk i ndalon asgjë për bërjen e çdo lloji të mundshëm të mëkatit dhe degradimit moral. Ata nuk i përmbahen fesë së Allahut dhe përmes sjelljes së tyre shtypëse, ata ndalojnë njerëzit e tjerë nga feja; ata nuk mund të durojnë të shohin zbatimin e standardeve dhe moralit fetar. Padyshim, shtypja e praktikuar prej këtyre njerëzve do të marr përgjigjen e merituar në Ahiret. Allahu na bën me dije në Kuran për këta njerëz dhe për fundin e tyre:

Me të vërtetë, ata që kanë mohuar dhe kanë larguar njerëzit nga rruga e Allahut, ata kanë humbur larg prej udhës së drejtë. Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, Allahu nuk i fal, as nuk do t'i udhëzojë në kurrfarë rruge, përveçse drejt rrugës së Xhehenemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Dhe kjo për Allahun është e lehtë. (Sure Nisa': 167-169)

Më poshtë, do të analizojmë tiparet dalluese dhe veçoritë e shtrembëruara të keqbërësve të cilët nuk posedojnë frikën e Allahut të përmendura në Kuran.

Ngjashmëria e tyre me Shejtanin

Ata njerëz të cilët, përkundër të qenit plotësisht të vetëdijshëm për ekzistencën dhe fuqinë e Allahut, nuk sillen në një mënyrë e cila kënaq Allahun, dhe të cilët në të vërtetë nuk i frikësohen Atij, ndajnë disa tipare të

përbashkëta me Shejtanin. Njerëzit të cilët janë pandërprerë nën këshillën dhe ndikimin e Shejtanit janë pothuajse të gatshëm të ndajnë një mentalitet dhe frymë të ngjashme. Treguesi më i qartë i kësaj ngjashmërie është gjendja e tyre e mohimit të verbër. Domethënë, ata automatikisht shfaqin reagime (reactions) të shtrembëruara dhe të çekuilibruara dhe qëndrime që janë të dëmshme për ta, në vend se të pranojnë atë që është e qartë dhe të sillen në pajtim me të. Shembulli më i mirë i sjelljes së tyre të shtrembëruar shihet në qëndrimin sfidues të Shejtanit ndaj Allahut. Kjo ndodhi rrëfëhet në Kuran si shembull për tërë njerëzimin.

Allahu krijoi engjëjt dhe xhindet përpara se të krijoi Ademin (as), njeriun dhe profetin e parë. Ata pandërprerë lëvdonin dhe madhëronin Allahun. Pastaj, Allahu krijoi Ademin (as) dhe urdhëroi engjëjt të bien në sexhde përpara tij. Engjëjt iu bindën urdhrat të Allahut me dëshirë dhe rranë në sexhde para Ademit (as). Mirëpo, Shejtani (Iblisi), i cili ishte i pranishëm me engjëjt, edhe pse ishte njëri prej xhindeve, ngriti krye kundër urdhrat të Allahut dhe u bë i pabindur ndaj Tij. Kjo për arsye se Shejtani besoi se ishte shumë më superior se Profeti Adem (as). Kurani rrëfen:

Zoti tha: “O Iblis, ç’ të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me duart e Mia? A mos u bërë mendjemadh apo mendon se je nga të lartët?” (Sure Sad: 75)

Në çka Shejtani përgjigjet:

“... Unë jam më i mirë se ai. Mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë prej balte”. (Sure Sad: 76)

Mosbindja e paturpshme e Shejtanit ndaj urdhrat të Allahut rezultoi me mallkimin dhe dënimin e tij me ndëshkimet e përjetshme të Xhehenemit. Pa dyshim, mosbindja e Shejtanit buron nga një gjendje e pakuptimtë e mospajtitimit shpirtëror. Ai personalisht ka qenë dëshmitar i ekzistencës së Allahut. Me të vërtetë, ai foli drejtpërdrejt me Allahun. Ai kishte dijeni të padyshimtë për vetitë e Allahut, fuqinë e Tij dhe ndëshkimin e përjetshëm të Xhehenemit.

Ngjashmëria e çuditshme në mes të Shejtanit dhe gjithë atyre të cilët i shmangen vetëdijes që frymëzon frikë-respekt ndaj Allahut buron brenda tyre. Të kesh dijeni të qartë për ekzistencën e Allahut dhe prapëseprapë të arrish ta mohosh Atë dhe të ngresh krye kundër autoritetit të Tij, paraqet një veçori vërtetë të habitshme. Duke e pasur parasysh diturinë e drejtpërdrejt dhe të padyshimtë të Shejtanit, njeriu do të priste që ai të kishte shkallën më të lartë të besimit dhe frikës ndaj Allahut. Gjithashtu, njeriu do të priste që ai të ketë edhe një nivel të vetëdijes së vazhdueshme që i përshtatet kësaj diturie, duke frymëzuar kështu respekt dhe bindje të pashembullt ndaj Allahut. Në vend të kësaj, Shejtani shfaq një paturpësi dhe guxim të shëmtuar.

Në ajetin më poshtë Kurani përshkruan gjendjen e këtyre njerëzve:

Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë “Allahu”. E ti (o Muhamed) thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” (Sure Junus: 31)

Një tjetër ajet zbulon gjendjen e tyre shpirtërore dhe mungesën e vetëdijes si vijon:

Mohuesit i shëmbëllejnë kafshëve, të cilat, kur i thërret dikush, dëgjojnë vetëm thirrje e zë, por s’kuptojnë asgjë. Ata janë të shurdhër, memecë dhe të verbër e nuk kuptojnë asgjë. (Sure Bekare: 171)

Një çështje tjetër që këta njerëz e mohojnë pa menduar fare është ringjallja. Për një person i cili e di se u krijua nga asgjëja dhe e di me siguri se në fund do të vdes, të pyes se si do të ringjallet, është pa asnjë dyshim, një gjë hutuese dhe e habitshme. Kurani i referohet Ditës së Ringjalljes dhe përshkruan reagimin mosbesues të njerëzve të cilët e mohojnë atë:

Nëse ti (Muhamed) çuditesh nga idhujtarët, janë vërtet të çuditshme fjalët e tyre: “Vallë, pasi të bëhemi dhé, do të krijohe mi vërtet përsëri?!” Këta janë ata që nuk besojnë në Zotin e tyre dhe në qafat e të cilëve do të ketë vargonj; këta janë banorët e Xhehenemit, në të cilin do të qëndrojnë përherë (Sure Rra’d: 5)

Krenaria dhe mendjemadhësia e tyre

Kur atij i thuhet “Kije frikë Allahun!”, ai mburret dhe bën më shumë të këqija. Atij i mjafton Xhehenemi. Eh, sa vendbanim i keq është ai vend! (Sure Bekare: 206)

Veçoria më e dallueshme e atyre të cilët nuk i frikësohen Allahut është gjendja e tyre e një krenarie dhe mendjemadhësie të pakuptim. Ajo që qëndron pas kësaj është personi që e sheh veten si të pavarur nga Allahu dhe që ia vesh vetvetes vetitë të cilat i takojnë vetëm Allahut. Kjo është një gjë krejtësisht absurde, pasi që njerëzimi është i dobët dhe ka shumë të meta. Pa marr parasysh se sa të lartë dhe të fuqishëm mund ta konsideroj ai vetveten, në fund do të lodhet, do të ketë uri, do të ketë etje, do ta marr gjumi, do të vuaj nga dhimbja e kokës apo sëmundje tjera, trupi i tij do të degjenerohet duke u plakur dhe në fund ai do të vdes dhe trupi i tij do të shpërbëhet.

Nuk është e mundshme që njerëzit të bëhen mendjemëdhenj dhe të sigurt në vetvete për sa kohë që janë të vetëdijshëm se është Allahu i Cili krijoi çdo gjë nga asgjëja, dhe i Cili na ka dhënë të gjitha karakteristikat dhe potencialin që posedojmë dhe se Ai është i aftë të marr mbrapsht gjithçka që na ka dhuruar kurdo që Ai të dëshiroj, dhe se të gjitha gjallesat janë të përkohshme dhe vetëm ekzistenca e Tij është e përjetshme. Mirëpo, vetëm ata të cilët i harrojnë të metat e tyre dhe intelektet e degjeneruara të të cilëve dështojnë t’i kuptojnë këto çështje do të merrnin guximin të jenë aq guximtar. Ky ishte rasti me Karunin, sjelljen e të cilit e përshkruan Allahu në Kuran si një shembull për mbarë njerëzimin.

Arsyeja që qëndron pas kryelartësisë së Karunit dhe paaftësisë së tij për t’iu frikësuar Allahut, ishte pasuria e tij. Ai kishte harruar se e gjithë pasuria i takon Allahut dhe po të dëshironte Ai do të mund të rimerrte këtë pasuri. Në vend të kësaj, ai parafytyroi se këto thesare ishin fituar nga ai vet si rezultat i aftësive të veta.

Me të vërtetë, Karuni ka qenë nga populli i Musait, por i shtypte ata. Ne i patëm dhënë atij aq thesare, saqë çelësat e tyre vështirë se do të

mund t'i mbante një grup njerëzish të fuqishëm. Njerëzit e popullit të tij i thanë: "Mos u ngazëlle me pasurinë që ke, sepse Allahu nuk i do ata që ngazëllehen! Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët." Ai tha: "Kjo më është dhënë vetëm prej dëturisë sime". Vallë, a nuk e dinte ai, se Allahu kishte zhdukur para tij shumë brezni, që kishin qenë më të fuqishëm dhe që kishin grumbulluar më shumë pasuri se ai? Por keqbërësit nuk do të pyeten për gjynahet e tyre. (Sure Kasas: 76-78)

Si shpëtim për këtë sjellje, Karuni u ndëshkua ndërsa ishte në Tokë për të shërbyer si shembull për njerëzit që kanë mendim të njëjtë. Po të posedonte ai, siç pohonte, fuqi dhe pushtet të pakrahasueshëm, ai padyshim do të kishte shpëtuar veten e tij nga ky ndëshkim. Mirëpo, as dijenia e tij, as pasuritë e tij, bashkësia ku ai jetonte apo respekti që ai gëzonte nuk ishin në gjendje që ta shpëtojnë atë nga ndëshkimi i Allahut.

Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t'i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten. Të nesërmen, ata që më parë dëshironin të kishin qenë në vend të tij, thoshin: "Është shumë e qartë se Allahu është Ai që i jep bollëk dhe ia pakëson kujt të dojë prej robërve të Tij. Sikur Allahu të mos kishte mëshirë për ne, me të vërtetë që do të na kishte bërë të na gëlltiste toka. Ububu! Është shumë e qartë se mohuesit nuk kanë shpëtim!" (Sure Kasas: 81-82)

Vdekja tragjike e Karunit përbën një shembull të hapur dhe të qartë për ata të cilët nuk posedojnë kurrfarë frike ndaj Allahut dhe të cilët janë hutuar nga mendjemadhësia. Mirëpo në Ahiret, është rezervuar një vend i këndshëm për ata njerëz të sinqertë të cilët nuk janë kryelartë:

Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhësi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat. (Sure Kasas: 83)

Lakmia dhe agresiviteti i tyre

Mendjemadhësia e këtyre njerëzve të cilëve u mungon plotësisht frika e Allahut ushqehet dhe mbahet gjallë prej tyre deri në atë masë sa ata përfytyrojnë se gjithçka është e tyre për të marrë. Për këtë arsye, ata kanë zili privilegjet e njerëzve të tjerë. Si shembull të këtij qëndrimi Kurani rrëfen ndodhinë e dy djemve të Profetit Adem (as):

Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë. Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd e kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit. Ky është ndëshkimi i keqbërësve”. Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit. (Sure Ma’ide: 27-30)

Një person i cili i frikësohet Allahut do të ishte i kujdesshëm dhe do të ruhej prej epsheve të tij të brendshme. Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë frikë e cila kërkon ndryshim të thellë të vet karakterit të njeriut në mënyrë pozitive. Vëllai i cili nuk iu frikësua Allahut iu dorëzua epsheve të shfrenuara të unit të tij. Si rezultat i xhelozisë dhe zemërimit për faktin se sakrifica e tij nuk u pranua dhe ndjenjës së rivalitetit që ai ndjeu ndaj vëllait të tij, ai përfundoi duke iu kërcënuar për ta vrarë dhe pastaj zbatoi këtë kërcënim. Ky rast shërben si paralajmërim se sa e rrezikshme mund të jetë t’ia kthesh shpinën frikës së Allahut dhe t’i dorëzohesh nxitjeve të epshit.

Një njeri i cili nuk i frikësohet Allahut nuk do të hezitojë, kur ndjehet personalisht i fyer, t’ju shkaktoj si dëm fizik ashtu edhe shpirtëror atyre të cilët e kanë fyer atë. Në të njëjtën kohë xhelozia është njëra prej tipareve dalluese themelore të Shejtanit. Kur Shejtani u dëbua nga prania e Allahut, ai shfaqti gjithë urrejtjen dhe xhelozinë që ndiente ndaj Profetit Adem (as) dhe premtoi se me gjithë fuqinë e tij do të tërhiqte në Xhehenem të gjithë pasardhësit e

ardhshëm të tij. Megjithatë, ky premtim vlen vetëm për shokët dhe përkrahësit e Shejtanit. Mirëpo, për ata besimtarë të cilët i frikësohen Allahut dhe të cilët janë të ndërgjegjshëm për veprimet e tyre, kjo nuk do të ketë asnjë ndikim çfarëdo qoftë.

Pavarësia e tyre

Të jesh “i pavarur” domethënë se njeriu nuk ka nevojë për çfarëdo qoftë, se njeriu është pa dobësi apo mangësi dhe se njeriu nuk mban përgjegjësi ndaj askujt. Këto veti i takojnë vetëm Allahut. Qeniet njerëzore dhe krijesat tjera të gjalla janë në thelb të dobëta dhe vazhdimisht kanë nevoja. Ata janë subjekt i qëllimeve të Allahut në këtë krijim dhe në çdo moment janë krejtësisht të varur prej Tij për jetesë dhe furnizim. Mirëpo, siç e kemi theksuar më lart, njerëzit të cilët nuk i frikësohen Allahut janë të verbuar prej vet paaftësisë së tyre për shkak të mendjeve të mbyllura dhe mençurisë së degjeneruar të tyre. Atyre kurrë s’do t’iu shkonte në mendje se mund të jenë të mangët ose me të meta. Veç kësaj, pasi që janë absolutisht të sigurt në veten e tyre, ata nuk hezitojnë dhe nuk janë kurrë të shqetësuar për kryerjen e veprave të këqija. Allahu i referohet kësaj gjendjeje shpirtërore në Kuran si të jesh “i shfrenuar.”

Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm. (Sure Alak: 6-7)

Këta njerëz jo vetëm që e konsiderojnë vetveten si tërësisht të pavarur, ata po ashtu e konsiderojnë vetveten si të liruar nga pasojat shkatërrimtare të veprimeve të tyre. Për këtë arsye, ata këmbëngulin në guximin e tyre të pamatur. Sa më e madhe që është bujaria e Allahut ndaj tyre, aq më të shkujdesur bëhen ata. Ata nuk e kuptojnë se Allahu është vetëm duke i vënë në sprovë, ashtu që sa më shumë që ata të vazhdojnë në shfrenim e tyre, aq më i madh do të jetë ndëshkimi të cilit ata do t’i nënshtrohen në Xhehenem.

Mos u josh (o Muhamed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre, sepse nëpërmjet tyre Allahu kërkon t’i ndëshkojë ata në këtë jetë, në mënyrë që t’u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë. (Sure Teube: 85)

Pasi që nuk janë të vetëdijshëm për këtë të vërtetë, ata keqkuptojnë mundësitë dhe burimet që Allahu ka lejuar t'i gëzojnë ata si mbrojtje prej ndëshkimit të Tij. Për shembull, ata mendojnë se një makinë e fortë dhe luksoze do ta mbrojë atë prej aksidenteve, lëndimit apo madje edhe prej vdekjes. Ata mendojnë se një ndërtesë e sigurt dhe e fortë do t'i mbrojë ata prej tërmeteve, katastrofave apo sulmeve. Natyrisht, një person mund të zgjedh të jetoj në një ndërtesë të sigurt si një masë paraprake, mirëpo, madje edhe ndërtesa më e sigurt e botës do të bëhet pluhur e hi kur të vjen koha.

Këta njerëz mendojnë po ashtu se ndërmarrja e çdo hapi parandalues që mund të merret me mend lidhur me shëndetin dhe ekzistencën e tyre fizike do t'i bëjnë ata rezistent ndaj vuajtjes. Mirëpo, kjo është një përpjekje absolutisht e pambarim. Madje edhe një virus i vetëm mjafton për të bartur ndëshkimin e Allahut te këta njerëz. Gjithashtu, shpërthimi i enws më të vogël të gjakut në tru do të mund të ishte fillimi i ndëshkimit të përjetshëm që do të pësojnë këta njerëz. Asnjë njeri tjetër dhe asnjë fuqi tjetër s'mund ta mbroj dikend prej ndëshkimit të Allahut. Allahu shpall në Kuran: **"... Hani nga ushqimet e shijshme e të lejuara me të cilat ju kemi furnizuar dhe mos e kapërceni kufirin, përndryshe do t'ju zërë zemërimi Im. Ai, të cilin e zë zemërimi Im, është i humbur!"** (Sure Ta Ha: 81)

Ata të cilët nuk kanë frikën e Allahut nuk e pranojnë madje as pashmangshmërinë e vdekjes. Për këta njerëz, vdekja e një të riu të afërt me ta, apo madje vdekja e papritur e personave të rëndësishëm apo njerëzve që janë të njohur për publikun, shikohet si një gjë tronditëse dhe e pakuptim. Të shohësh një person më parë të shëndoshë dhe të fuqishëm të bëhet i panjohshëm vjen si një goditje e rëndë për njerëzit të cilët do të parapëlqenin të harrojnë vdekjen.

Gjithashtu, për ta të shohin një shok me të cilin ata mund të kenë qenë bashkë disa ditë më parë, të gjetur skaj rrugës në një gjendje që s'mund ta njohin, që e ka goditur vetura dhe pastaj t'ju duhet të jenë dëshmitar kur këtë trup e fusin në një thes të zi kufomash, të mbyllur që nga koka e deri te këmbët, do t'ju sjell ndërmend shumë gjëra që ata mundohen t'i harrojnë. Të shohin

dikë të moshës, mënyrës së jetës dhe mentalitetit të tyre, të shtrirë në rrugë me kufomën e rrethuar nga një turmë njerëzish, do të mbushte zemrat e tyre me ndërgjegjësimin e frikshëm se janë tërësisht të papërgatitur për vdekjen e tyre dhe për Ahiretin. Disa ditë më herët ata do të kenë qenë duke u krekosur me veshjen e “modelistit” të tyre dhe duke ndjekur ambiciet e tyre profesionale, duke pohuar që nuk kanë aspak kohë për fe dhe duke bërë shaka për Ahiretin. Krejt papritur, të ballafaquar me pamjen e shokut të dikurshëm, ata e gjejnë veten në një gjendje krejtësisht tjetër shpirtërore. Personeli i emergjencës do të mbledh xhamat e thyer që kanë rënë në tokë për t’i hedhur, këpucët e tij të dëmtuara dhe rrobat moderne që kishte veshur. Trupi i tij një kohë krenar do të dërgohet menjëherë në morgun e spitalit për të parandaluar kalbjen e tij dhe do të lihet aty me kufomat tjera. Ajo që dikur ishte një qenie njerëzore do të mbështillet në një pëlhurë të bardhë dhe brenda disa ditëve do të vendoset në një gropë në dhe.

Mirëpo, për shumicën prej tyre kjo frikë do të jetë jetë-shkurt. Brenda një periudhe të shkurt ata do t’i kthehen mendësisë së mëparshme të tyre, duke e konsideruar vdekjen si diçka që ndikon në çdonjërin përveç në ata vet. Përkundër asaj se shohin njerëzit rreth tyre duke vdekur, përkundër dijenisë se i pret Ahireti, përkundër plakjes së trupave të tyre dhe afrimit gradual drejt fundit, ata nuk i frikësohen Allahut dhe kështu refuzojnë plotësisht të mendojnë për vdekjen. Për këtë arsye, në vend se të përdorin sadopak nga ajo pak kohë që mund t’ju ketë mbetur për të ndryshuar mënyrën e tyre të jetës dhe t’i nënshtrohen udhëzimit të Allahut, ata zgjedhin të ndjekin një nivel gjithmonë në rritje të pakujdesisë.

Jetët përplot frika dhe shqetësime

Për njerëzit të cilët nuk i besojnë apo nuk i frikësohen Allahut e gjithë bota përbëhet prej kaosit dhe rastësive. Ata mendojnë se çdo gjë ndodhë rastësisht dhe se ngjarjet që ndodhin rreth tyre ndodhin pa kuptim apo arsye. Në rrethana të tilla është e pamundshme të përjetohet çfarëdo ndjenje e qëndrueshme e

paqes dhe qetësisë së vërtetë, pasi që në çdo moment ata do të mund të përballen me ndonjë fatkeqësi arbitrare. Ai ka shqetësime dhe frika të pafund lidhur me të ardhmen. Për shembull, ai do të mund të sëmurej nga një sëmundje e papritur, të humb tërë pasurinë e tij apo mbase një gjëmë e papritur do të mund t'i ndodhte atij apo njerëzve të dashur të tij. Pasi që ai supozon se të gjitha ngjarjet si këto ndodhin me apo pa dashje, ai kurrë nuk ndjehet i lirë nga shqetësimi dhe frika për mundësinë që ato t'i ndodhin atij. Dhe për më tepër, gjendja bëhet edhe më e keqe për arsye të njohurisë së e gjithë kjo punë është tërësisht jashtë kontrollit të tij, duke e lënë atë me një ndjenjë të rritur të pafuqisë dhe dëshpërimit.

Vetëm dikush i cili i frikësohet Allahut nuk do t'ju nënshtrohet këtyre llojeve të frikës. Frika e Allahut dhe besimi në Të largon të gjithë këto frika tjera. Të kesh dijeni se Allahu është Zotëruesi dhe Krijuesi i çdo gjëje dhe se asnjë ngjarje nuk ndodhë veçse nën kontrollin dhe largpamësinë hyjnore të Allahut, duke e ditur se Allahu do t'i mbrojtë dhe do të kujdeset për ata të cilët kanë besim në Të, udhëzon në lirim nga çdo lloj frike dhe nevojë të rrejshme. Kurani shpall:

All-llahu solli një shembull: Një njeri (rob) në posedimin e të cilit ishin ortakë pa marrëveshje mes vete dhe njëri (rob) që është thjesht në posedimin e një njeriu. A janë ata të dy të një lloji (të një gjendjeje)? Lavdërimi i takon vetëm All-llahut, por shumica e tyre, nuk e dinë. (Sure Zumer: 29)

Njerëzit të cilët nuk besojnë në Allahun dhe të cilët si pasojë nuk i frikësohen Atij, do të përjetojnë një mori frikash të ndryshme në raport me gjërat tjera dhe njerëzit tjerë. Ata kurrë nuk mendojnë për të qenit përgjegjës ndaj Allahut për veprimet e tyre por janë shumë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre ndaj eprorëve të tyre në punë, bashkëshorteve të tyre, nënave të tyre, etërve të tyre dhe shumë njerëzve tjerë të tillë.

Kur ndjenja e frikës, e cila duhet t'i drejtohet vetëm Allahut, i drejtohet krijimit të Tij në vend të Tij, i ul individët në fjalë në një pozitë të padenjë pasi

që e vetmja qenie e cila vërtetë e meriton t'i frikësohemi është Allahu. Ai është zotëruesi i gjithë fuqisë dhe pushtetit dhe çdo gjë i nënshtrohet vullnetit dhe kontrollit të Tij. Asgjë nuk vjen në jetë përveç se me vullnetin dhe dijen e Tij. Pa pëlqimin e Tij, asgjë s'mund t'i shkaktojë dëm askujt. Andaj, nuk ekziston asnjë qenie tjetër që duhet t'i frikësohemi përveç Allahut.

Siç vërejtëm më herët, njerëzit të cilët iu frikësohen njerëzve të tjerë e jo Allahut veprojnë ashtu sepse i konsiderojnë ata si posedues të fuqisë dhe pushtetit që është i pavarur nga Allahu. Ata e bëjnë gabimin e tmerrshëm të refuzimit të Allahut dhe kërkimit ndihmë nga krijimi i Tij në vend të Tij. Si rezultat, ata jo vetëm që nuk pranojnë ndihmën që e kërkojnë, por gjithë jetët e tyre dëmtohen nga ekspozimi i dëmshëm ndaj paditurisë, kokfortwisiw dhe të metave tjera njerëzore të atyre në të cilët janë mbështetur ata, që ata kanë parapëlqyer para Allahut.

Allahu ka urdhëruar ata të cilët besojnë që t'mos iu frikësohen njerëzve tjerë por t'i frikësohen vetëm Atij:

**... Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje!
Dhe mos i ndërroni Fjalët e Mia me ndonjë vlerë të vogël! Kushdo që
nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është mohues i vërtetë.
(Sure Ma'ide: 44)**

**... por atyre mos iu frikësoni, frikësohuni vetëm prej Meje -, që të
plotësoj mirësinë Time ndaj jush dhe që ju të shkoni në udhë të drejtë.
(Sure Bekare: 150)**

Pandershmëria dhe mosmirënjohja e tyre

Ka shumë shembuj në Kuran të mosfalënderimit të atyre të cilët nuk i frikësohen Allahut. Mirëpo, mbase ai që flet më së shumti ka të bëjë me të bijtë e Izraelit dhe pandershmërinë dhe mosmirënjohjen e tyre ndaj Allahut dhe të dërguarve të Tij.

Bijve të Izraelit iu dhuruan të mira që nuk iu dhuruan asnjëherë më parë

asnjë populli tjetër. Atyre iu demonstruan mrekulli të panumërta dhe përkundër faktit se profetët dolën nga mesi i tyre, ata mbetën faktorë të pabindur të cilët nuk u prekën nga asnjëra prej tyre. Profeti Musa (Mojsiu) (as) me durim u përpoq t'i mësoj ata, por ata nuk e arritën bindjen e vërtetë ndaj Allahut dhe besimit të vërtetë. Kur ata u bënë dëshmitar të zemërimit të Allahut, ata kërkuan faljen e Tij dhe kur zemërimi i Tij u hoq, ata iu kthyen keqbërjes së tyre, duke përvetësuar madje zota tjerë pos Tij. Ndërsa profetët e tyre ishin të përfshirë në luftëra të vështira me jobesimtarët, dyfytirëshit nga mesi i bijve të Izraelit ishin më të interesuar që të sigurojnë përparësi për veten e tyre dhe përfitime personale dhe kurrë nuk ishin me të vërtetë të sinqertë në përmbushjen e obligimeve të tyre ndaj Allahut dhe fesë së Tij.

Duke shfaqur mosmirënjohje të plotë, ata braktisën profetin e tyre, Musain (as), duke e lënë atë vetëm në fazën më kritike të luftës së tij, duke u përqendruar në vend të kësaj në mirëqenien dhe mjetet e tyre të jetesës. Pastaj, sikur kjo të mos mjaftonte, ata shfaqën po ashtu qëndrimin më të turpshëm dhe më jo-falënderues ndaj tij.

Ata thanë: “O Musa! Kurrësi nuk do të hyjmë atje, derisa aty të gjenden ata. Kështu që shko ti dhe Zoti yt e luftoni, se ne do të rrimë këtu”. (Sure Ma’ide: 24)

Nga kjo mund të shihet qartë se njerëz të tillë sikur këta nuk posedojnë frikën e Allahut, prandaj, kur ata përballen me çfarëdo që bie ndesh me interesat e tyre ata menjëherë bëhen të pabindur. Përkundër mbrojtjes që ata pranuan nga Allahu dhe të dërguarit e Tij kundër tiranisë së armikut të tyre më të vrazhdë, Faraonit të Egjiptit, pavarësisht nga të mirat e panumërta dhe thirrjet e vazhdueshme në besim dhe shpëtim të përjetshëm, e gjithë kjo u harrua për një çast.

PASOJAT QË VUAJNË ATA TË CILËT NUK I FRIKËSOHEN ALLAHUT

Pasojat që përjetojnë në Tokë

Allahu do t'i bëjë ata njerëz të cilët nuk i frikësohen Atij dhe të cilët nuk janë të vëmendshëm ndaj Tij të përjetojnë si vuajtje fizike ashtu edhe shpirtërore në këtë dynja. Në realitet jetët e tyre do të shndërrohen në një varg të gjatë fatkeqësish fizike dhe emocionale.

Pavarësisht nga të gjitha veprat e këqija të tyre disa prej tyre e lejojnë vetveten të mashtrohen nga fakti se ata mund të kenë qenë të bekuar me dhunti të tilla si pasuria apo pamja e bukur. Andaj ata këmbëngulin në mos-përmbajtjen e tyre, duke e mashtruar vetveten se gjërat nuk mund të ishin më mirë. Mirëpo, ata nuk janë të vetëdijshëm se çdo gjë që bëjnë regjistrohet në çdo moment, dhe se në Xhehenem, Allahu do t'i ballafaqojë me të gjitha këto si burim i ndëshkimit të pambarim. Allahu përshkruan gjendjen e tyre në Kuran:

Andaj, lëri ata në padijen e tyre për një farë kohe! A mos mendojnë ata që Ne, duke u ardhur në ndihmë me pasuri dhe djem, po nxitojmë drejt tyre me të mira?! Kurrresi, por ata nuk janë të vetëdijshëm (për këtë). (Sure Muminun: 54-56)

Por, ndëshkimi nuk është i njëjtë për të gjithë ata. Disa prej tyre do të përjetojnë ndëshkimet e tyre në Tokë. Ata do të jenë në një gjendje të humbjes së vazhdueshme duke përjetuar sëmundje, aksidente, paaftësi, kriza financiare

dhe humbjen e të dashurve të tyre. Pasi që ata nuk reflektojnë për këto ngjarje si sprova nga Allahu, ankthi me të cilin ndeshen shndërrohet në një formë ndëshkimi për ta. Allahu nuk do të lejojë kurrë që diçka të shkoj si duhet për këta njerëz. Ata do të përjetojnë vazhdimisht mungesa dhe pengesa. Pa marr parasysh se a përfshihen në diçka të madhe apo të vogël, ajo do të rezultojë me humbje materiale apo shpirtërore. Pastaj, Allahu nxjerr përfundimin në Kuran se shpërblimi i tyre do të jetë një jetë plot ankth:

Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. (Sure Ta Ha: 124)

Gjendja e errësirës shpirtërore e përjetuar nga njerëzit të cilët nuk i frikësohen Allahut reflektohet në fytyrat e tyre. Kur kjo mungesë e ndriçimit shpirtëror bashkohet me fjalimin e tyre të shtrembëruar, natyra e trazuar e ekzistencës së tyre bëhet e qartë. Ata janë mishërimi fizik i dekadencës dhe çoroditjes shpirtërore. Allahu kësaj i është referuar në Kuran si “poshtërim”:

Kurse ata që bëjnë vepra të këqija, do të kenë dënim gjegjës për atë të keqe. Ata do t’i mbulojë poshtërimi, pa pasur askënd që t’i mbrojë nga dënimi i Allahut, me fytyrat e tyre si të ishin të mbuluara me copa të errëta nate. Këta do të jenë banorët e zjarrit dhe aty do të qëndrojnë përgjithmonë. (Sure Junus: 27)

Një tjetër humbje që bëhen të vuajnë është tërheqja subtile e intelektit dhe aftësisë së tyre për të kuptuar. Ata nuk mund të kuptojnë madje as edhe të vërtetat më themelore. Për shembull, ata nuk janë në gjendje të kuptojnë arsyet që qëndrojnë pas pakënaqësisë, frikës, ankthit dhe zhgënjimit të tyre.

Shumëllojshmëria e ndëshkimeve që do të pësojnë ata të cilët nuk e kanë frikën e Allahut është pambarim e larmishme. Allahu krijoi njeriun dhe është plotësisht i vetëdijshëm se çka shkakton agoninë më të madhe. Prandaj, njeriu vetëm mund të përpiqet të imagjinoj dhimbjen dhe vuajtjen e shkaktuar nga urrejtja e Allahut:

... Urrëjtja e Allahut ndaj jush është më e madhe se urrejtja juaj ndaj vetvetes, kur jeni thirrur në besim, por keni mohuar. (Sure Gafir: 10)

S’është nevoja të thuhet që askush me mendje të shëndoshë nuk do të

këmbëngulte në sjelljen dhe qëndrimet që do t'i shpinin ata drejt ndëshkimit të Allahut. Paaftësia e njeriut për tu përballur madje me shqetësimet të përditshme, të rëndomta është provë e qartë e kësaj dobësie. Për shembull, është krejtësisht e kuptueshme që një njeri do ta konsideronte absolutisht të padurueshme dhimbjen torturuese. Mirëpo, është po ashtu e vërtetë se nëse njeriut i duhet të dëgjoj, madje edhe nga largësia, klithmën e dikujt në agoni mjafton për të shkaktuar një ankth të papërshkrueshëm. Kjo për arsye se njerëzimi nuk është krijuar për t'i qëndruar dhimbjes shpirtërore dhe fizike, frikës apo tendosjes. Ne nuk mund të durojmë që të jemi të mbyllur në hapësira të ngushta për një kohë të gjatë apo tu ekspozohemi erërave kutërbuese, apo dhimbjes së madhe të stomakut ose dhimbjes së dhëmbit. Duhet të kemi parasysh se këto nuk janë forma të ndëshkimit, por më tepër, vuajtje të rëndomta të cilat formojnë një pjesë të jetës së përditshme.

Pavarësisht nga këto të vërteta të qarta, njerëzit në përgjithësi çojnë një jetë shumë të largët nga frika e Allahut për arsye të gjendjes së tyre të pakujdesisë dhe pamendësisë. Mirëpo, dhimbjet shpirtërore dhe fizike të cilat përjetohen në Tokë janë vetëm një shembull i vogël i ndëshkimit që do të pësojnë në Xhehenem dhe shërbejnë vetëm si një shembull dhe paralajmërim. Këta njerëz nuk kanë kurrfarë kujdesi për pushtetin dhe forcën e pafund të Allahut, e megjithatë, kur ata i arrin vdekja, ata do të ndiejnë madhështinë e Allahut me tërë forcën dhe ashpërsinë e saj dhe do të kaplohen nga një frikë e cila është e papërshkrueshme dhe e pakrahasueshme me çfarëdo që përjetohet në Tokë.

Përveç ndëshkimeve individuale, Kurani është përplot me shembuj të grupeve të njerëzve të cilët janë zhdukur për arsye të ndëshkimeve të dërguara prej Allahut. Këta njerëz u zhdukën për një çast për shkak të kryengritjes dhe mosbindjes ndaj kufijve të Allahut.

Allahu ka dërguar vorbullat ere kundër disave, të cilat i kanë ndarë më dysh shtëpitë e tyre, ai ka dërguar një klithmë, e cila i ka rrafshuar qytetet e tyre. Në lidhje me tërmetet, aq shumë grupe njerëzish janë varrosur me gjithë pasurinë e tyre, ndërsa të tjerët janë fundosur dhe të tjerët janë shndërruar në gurë kur

janë mbështjellur nga llava e nxehtë. (Për informacion të mëtejme, ju lutem shihni *Kombet e zhdukura* nga Harun Jahja, Botuesit Taha (Taha Publishers), Londër, botimi i 5-të i vitit 2003)

Gjendja e tyre në Ahiret

Njerëzit kanë një kohë shumë të kufizuar në Tokë prej rreth 60 deri 70 vjet. Sa çel e mbyll sytë, kanë kaluar 50 vjet jete të njeriut: njeriu ka mbaruar shkollimin, ka gjetur punë të mirë, ka blerë veturë të mirë, është martuar si duhet, ka blerë shtëpi, ka pasur disa fëmijë dhe trupi i tij është mbuluar me rrudha. Me rreth pesë deri 10 vjet të mbetura, njeriu ndjen afrimin e vdekjes. Megjithatë, ajo që është më e habitshme është se disa njerëz do të vazhdojnë të mohojnë pashmangshmërinë e saj dhe bëhen të vendosur që ato disa vite që ju kanë mbetur t'i kalojnë pa menduar për vdekjen. Allahu paralajmëron njerëzit të cilët janë në këtë gjendje:

E sa mirë do të dëgjojnë e do të shohin atë Ditë, kur do të vijnë te Ne! Por, sot keqbërësit janë në humbje të qartë! Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë. (Sure Merjem: 38-39)

Në fund të jetës së tyre të shthurur këta njerëz pandehin se do t'i dorëzojnë qetë shpirtat e tyre të pushojnë në paqe të përjetshme, mirëpo ata do t'i pret një zgjim i ashpër. Në vend të kësaj, atëherë kur më se paku e presin, ata do ta gjinden përballë engjëjve të vdekjes të caktuar për ta. Këta engjëj veprojnë sipas urdhrave të Allahut dhe janë mospërfillës ndaj përgjërimit dhe lutjeve të atyre për të cilët janë përgjegjës. Kur engjëjt e vdekjes të vijnë të marrin shpirtat e tyre me tronditjen e goditjeve të ashpra në shpinat e tyre dhe dhimbjen djegëse, ata do të jenë plotësisht të vetëdijshëm për atë që po u ndodhë atyre:

Sikur t'i kishe parë engjëjt kur ua marrin shpirtin atyre që mohuan (do të shihje tmerr), u binin fytyrave dhe shpinave të tyre (para, prapa): "Shijoni dënimin e djegies!" (Sure Enfal: 50)

Krimi i kryer nga ana e jobesimtarëve është krim i rëndë dhe ndëshkimi i tyre do të zgjas për gjithë kohën. Nuk do të ketë mundësi ikjeje apo lirimi nga vdekja; thënë shkurt, nuk ekziston asnjë mënyrë çlirimi apo shpëtimi. Kjo për arsye se ata kanë ngritur krye kundër Allahut i Cili ka krijuar çdo gjë nga asgjëja, Zotëruesi i vërtetë i çdo gjëje, Zotëruesi i fuqisë dhe dijenisë së pafund, Zoti i gjithësisë.

Këta njerëz nuk iu frikësuan Allahut derisa ishin në Tokë, kështu që në Ahiret Ai do t'i nënshtroj ata ndaj frikave çfarë ata kurrë nuk kanë përjetuar apo me të cilat kurrë nuk janë përballur: ata do të jenë të rrethuar nga frika, llahtari dhe ankthi përgjithmonë:

Do t'i shohësh jobesimtarët të frikësuar nga ajo që vepruan, po, ajo do t'u ndodhë atyre... (Sure Shura: 22)

Këta njerëz të cilët kanë kaluar tërë jetën e tyre në pakujdesi dhe fundi i të cilëve është duke u afruar me shpejtësi, do të sulmohen nga një frikë dhe tmerr që s'ka mbarim. Jetët e tyre janë thjeshtë një hyrje e zgjatur ndaj tmerreve që do të pasojnë e që janë në duart e Allahut, i Cili deri atëherë vetëm “... **ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen**” (Sure Ibrahim: 42) Frika me të cilën do të përballen ata në Ditën e Gjykimit do të bashkohet me shushatje, siç përshkruhet në Kuran:

(përkujto) Ditën kur i fryhet surit, e të frikësohet kush është në tokë, përpos kë do All-llahu (të mos frikësohet) dhe t'i vijnë Atij të gjithë të përulur. (Sure Neml: 87)

Në Ditën e Gjykimit ndërsa njerëzit janë në gjendje paniku, gratë shtatzënë do të abortojnë foshnjat e tyre për shkak të kësaj frike. Tmerri i ndëshkimit të cilit do t'i nënshtrohen ata do të bëj që njerëzit të humbin mendjen:

O ju njerëz, ruajuni dënimit nga Zoti juaj, sepse dridhja pranë katastrofës së kiametit është një llahtari e madhe. Atë ditë, kur ta përjetoni atë, secila gji-dhënëse braktis atë që ka për gjini dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, po ata nuk janë të dehur, por dënimi i All-llahut është i ashpër. (Sure Haxhxh: 1-2)

Ky është vetëm fillimi. Ata do të përjetojnë ndëshkime të cilat tejkalojnë aftësinë e imagjinatës sonë. Allahu Zotëruesi i fuqisë dhe drejtësisë së pafund do të hakmerret, duke përdorur vetinë e Tij të Hakmarrësit (Muntekim). As të qarit, përgjërimit, britmat, luftimi, ndjenja e pendimit apo përgjërimit për falje s' do të kenë kurrfarë efekti. Askush nuk do të jetë në gjendje t'ju ndihmojë jobesimtarëve. Pa marr parasysh se çfarë bëjnë ata, nuk do të ndryshojë asgjë; se a pranojnë ata gjynahet e tyre dhe a pendohen apo jo, nëse janë apo jo të palëkundur, është tepër vonë për çdo gjë. Allahu na ka tërhequr vëmendjen ndaj kësaj përpjekjeje të pashpresë:

“Hyni në të! Për juve është njësoj, bëtë durim ose nuk bëtë. Shpërbleheni me atë që me veprat tuaja e merituat.” (Sure Tur: 16)

Nuk ka rrugëdalje për njerëzit të cilët kanë arritur këtë shkallë. Ndërsa ata ishin në Tokë ata ishin vazhdimisht të përkujtuar gjatë gjithë jetës së tyre me këshilla të panumërta dhe paralajmërime të frikshme. Veç kësaj, atyre u janë dhënë mjete dhe burime të panumërta, ndërsa gjëja e vetme që është kërkuar prej tyre ishte se ata duhet t'ju vënë veshin ndërgjegjeve të tyre, i frikësohen Allahut dhe veprojnë me kujdes.

Ata do të përgjërohen për mëshirën e Allahut, edhe pse derisa ishin në Tokë mendjemadhësia dhe fodullëku i tyre i kanë ndaluar ata që ta bëjnë këtë, dhe po ashtu i kanë ndaluar ata që të përgatiten për vdekjen e tyre dhe dhënies e llogarisë në Ahiret. Prandaj, në Ditën e Gjykimit ata tërhiqen zvarrë në fytyrat e tyre për në vendin e tyre të ndëshkimit, ku ata do të përjetojnë si dhimbje fizike ashtu edhe shpirtërore, fuqinë e të cilave ata s'kanë mundur kurrë ta paramendojnë.

Kur të ringjallen jobesimtarët do të shohin se mendjemadhësia e tyre është zhdukur tërësisht dhe do të jenë në një gjendje të thyer dhe të pikëlluar. Ata do të futen në Xhehenem dhe dyert e tij do të mbyllen prapa tyre dhe aty ata do të përballen me një skenar dhimbjeje dhe llahtari që kundërshton haptas çfarëdo përpjekje përshkrimi para se të hidhen në Zjarr. Asnjë dhimbje në Tokë nuk do

të mund të krahasojë kurrë me agonitë e Xhehenemit, pasi që Allahu e ka krijuar atë si një ndëshkim që tejkalon të gjitha ndëshkimet:

Atë Ditë, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai, e askush nuk do të lidhë në pranga siç lidh Ai! (Sure Fexhr: 25-26)

Dhimbja torturuese fizike në njërën anë dhe agonja e papërballueshme shpirtërore në anën tjetër, do të torturojnë viktimat e tyre. Ata do të keqtrajtohen, çnderohen, degradohen dhe nënvleftësohen. Ndjenja e dëshpërimit, e diturisë se ata kurrë ndonjëherë nuk do të dalin prej Xhehenemit, do të mbështjell krejtësisht shpirtrat e tyre tek ata përballen me një përjetësi frike, tmerri dhe vuajtjeje të pambarim.

PËRFUNDIM

Çfarë ndryshimi do të përbënte për jetën e njeriut nëse njeriut do t'i lejohej t'i shoh me sytë e vet demonët e Xhehenemit duke i ndëshkuar viktimat e tyre, gjëmimin e flakëve, ulërimën e çmendur të të dënuarve, rënkimin dhe ofshamën e padurueshme të tyre, përpëlitjen e tyre për të marr frymë dhe përgjërimin e tyre të pushtuar nga paniku për t'i lejuar që të kthehen në Tokë.

Pa dyshim, njeriu do të bëhej një person i ri, njeriu do të rirregullonte tërë jetën e tij. Fakti se çdokush tjetër mund të jetë i pavëmendshëm ndaj këtij realiteti nuk do të ndalonte njeriun që të përpiquej me tërë forcën e tij për Ahiret. Njeriu do ta largonte veten e tij nga çdo formë e sjelljes e cila është e dënueshme për Allahun dhe njeriu do të bënte punë të mira sa më shumë që të ishte e mundshme. Njeriu do të ngjetej nga mendimi i bërjes qoftë edhe të mëkatit më të vogël apo bërjes së çfarëdo vërejtjeje që do të mund të rrezikonte të ardhmen e tij në Ahiret. Njeriu menjëherë do t'i drejtohej Allahut duke ulutur dhe duke kërkuar faljen e Tij. Pamjet e gjërave që njeriu kishte parë apo dëgjuar s'do të largoheshin kurrë nga mendja e tij, duke bërë që njeriu të kërkoj strehim tek Allahu për mbrojtje nga një telash i ngjashëm.

Për të fituar dashurinë e Allahut dhe për të qenë i sigurt prej ndëshkimit të Tij një person i tillë do ta përkushtonte tërë jetën e tij, pasurinë dhe energjinë e tij për hir të Tij. Mbi të gjitha, ai do të ishte i palëkundur dhe i vendosur deri në vdekje, madje edhe vuajtja më e madhe do të bëhej e padurueshme. Askush s'do mund ta shpërqendronte nga qëllimi i tij, ai do të ishte plotësisht i paepur

në kërkimin e kënaqësisë e Allahut. Ai do të shfrytëzonte secilën mundësi të bënte sa më shumë që të ishte e mundshme për të mirën e tij në Ahiret. Se çfarë vepronjë të tjerët, çfarë mënyra jetese kanë dhe cilat ideologji pasojnë s' do të paraqiste asnjë rëndësi çfarëdo qoftë për të. Sikurse që do të ishte i ndjeshëm ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut, ai po ashtu do t'ju shpjegonte ato njerëzve tjerë, duke këshilluar dhe paralajmëruar çdo njeri që takon për realitetin e jetës. Qëllimi më i madh i tij, ambicia jetësore e tij do të ishte të fitoj miqësinë e Allahut, duke ia nënshtruar veten e tij plotësisht Atij. Ai do të mishëronte llojin e frikës së përshkruar në Kuran:

... ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja. (Sure Bekare: 74)

Nëse është fakti se ne nuk e kemi parë Xhehenemin ai që po i ndalon disa njerëz që të kenë frikën e Allahut ashtu si duhet dhe për të qenë të kujdesshëm në jetën e tyre të përditshme, duhet të mjaftoj fakti se Ai ka treguar për ekzistencën e Xhehenemit pandërprerë në Kuran, duke e përshkruar atë gjer në hollësinë më të vogël dhe duke i paralajmëruar njerëzit për të.

Kur të vjen koha nuk do të mbetet asnjë njeri që nuk do ta shoh Xhehenemin. Allahu e ka bërë këtë absolutisht të qartë. Vetëm ata të cilët i frikësohen Allahut do të jenë të shpëtuar prej tij, të tjerët do të lihen në të të gjunjëzuar:

Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt. Pastaj do t'i shpëtojmë ata që kanë qenë besimtarë dhe do t'i lëmë keqbërësit të gjunjëzuar në të. (Sure Merjem: 71-72)

Mirëpo, nuk do të fitohet asnjë dobi apo përfitim nga pamja e Xhehenemit në këtë çast, sepse atëherë, njeriu veçse është matanë pikës prej nga nuk ka kthim...

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkencë vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshtat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darwin. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darwinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegojë se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë forcë evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuara dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet

asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një genie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themel in e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864,

Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”¹

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.²

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.³

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.⁴

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet

për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?*⁵

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohet një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo

e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëriën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁶

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*“...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë

evolimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁷

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.⁸

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtuan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁹

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se

mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishite qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishite me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të

çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”¹⁰

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.¹¹

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë

zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.¹²

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.¹³

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo”

ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucionari. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij *Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”*¹⁴

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleoantropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.¹⁵

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiensi, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.¹⁶

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhën) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.*¹⁷

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.¹⁸

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zharrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi,

atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepër, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilëso prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u

bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në

ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me

njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorieve shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si “sulm ndaj shkencës”. Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë

mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.¹⁹

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe

gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjeputura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t’i largojë njerëzit nga e

vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, “magjia” është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe

përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

*Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.*²⁰

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshtëm e i Urtë.”
(Sure Bekare: 32)***

SHËNIMET

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darëin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection, The Modern Library*, Neë York, p. 127.
8. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neë York, 1983. p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Eëalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Eëith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, p. 19.
19. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Eëorld," *The Neë York Revieë of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43.